

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7351 E diel 12 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Ky është mesazhi i qartë që dha përdje në konferencën për shtyp në Tiranë dhe në aktivitetet e tjera Komisioneri i Zgjerimit të BE-së, Johannes Hahn. ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Prapë hapa, pastaj data!



Dje

në "Deutsche Welle"

Admirina Peçi sheh me kureshtje të madhe qindra fletorkat e zverdhura e të rrjepura, të radhitura me kujdes nëpër raftet e metalta. Është hera e parë ...
Vijon në faqen 22

Nga ANILA SHUKA

Ballafaqimi me të shkuarën, ende në nxehtë



Alketa Hatija: Nuk kam bunker në Berat

"Zoti i drogës" flet nga arratia: Ja lidhja ime me bandat e trafikut


I dënuari në Itali akuzohet se ka lëvizur në një vit 350 kg heroinë dhe 190 kg kokainë

Në mediat italiane shkruhet se ai trafikoi vetëm në një vit, 350 kg heroinë dhe 190 kg kokainë. Alket Hatija, njeriu që cilësohet nga mediat italiane si "Zoti i drogës", foli dje në një rrëfim ekskluziv për emisionin "Kjo javë" të moderatores Nisida Tufa, në "News 24". Nga baza ku fshihet, ai pranon për gazetaren ...
Në faqen 8

AGJENCIA E PRONAVE: DOKUMENTET PER TE APLIKUAR NE PORTALIN "E-ALBANIA"

PRONAT, PROCEDURA E RE PER KOMPENSIMIN

Aplikimet për trajtimin të dosjes me specialistin përkatës dhe kërkesat për statusin e çështjes, si të përdorni shërbimin elektronik



(Në foto) Prona (foto ilustruese). Formulari i aplikimit për trajtimin e dosjes

Në faqen 5

"PAKTI I KRETES"

Bushati-Kotzias bien dakord për ndarjen e kufijve detarë në jug

Në faqen 4

PERGJIMET

Miku i Gentian Dodës "fundosi" gjyqtarin e Gjykatës së Apelit

Në faqen 6

1 MIJE EMRA

Të përndjekurit, trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblimin

Në faqen 10-11

140 MIJE PERFITUES

Amnistia për makinat, afat deri në fund të vitit për taksat

Në faqen 9

EMRAT



Sekuestrohen 1.5 tonë hashash në Velipojë, 7 vetë në pranga

Në faqen 7

MILOSIO

Studimi i Panajot Barkës: Rëndësia e qytetit të Epirit në botën antike

Finiqi dhe drama e fshehjes së të vërtetës

Në brendësi: Tragjedia e liceistëve të Korçës. Poezi nga Demir Gjergji

Nga PANAJOT BARKA

Zbulimi i Dodonës me 1875 vërtetoi se civilizimi i saj i dha identitetin kulturor Epirit dhe Greqisë; lidhjen e saj me gjeografinë themeleuese të botës mitologjike greke konkretizimin e perandorisë homerike dhe të mar-



rëdhënieve të heronjve mitologjikë me Epirin. Vërtetoi se Dodona përbënte gjenезën e teogonisë së sistemit politeist grek dhe të kozmogonisë në tërësi. Vërtetuan se në vetë Epirin, civilizimi "qytetës" (sipas modelit të poliseve ...

Suplement

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Deputeti i PD-së: "Këshilli i Sigurisë" të zbardhet, ka të dhëna konkrete

Flamur Noka: Rama 'peshku i madh', i ka mbetur droga pa shitur, jo se e luftoi

Deputeti i PD, Flamur Noka, tha dje gjatë intervistës në emisionin "Kjo Javë" në "News 24" se zbardhja e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, i mbledhur në 11 nëntor të vitit të kaluar për çështjen e drogës është urgjente. "Qeveria është kapur dhe u nxor në pah se doli me paratë e krimin. Ne besojmë se ka të dhëna konkrete, zbardhja e të cilave hedh dritë dhe është urgjente. Në dijeninë tonë është folur për emra konkretë, ku ka emra të njohur të përfshirë në trafikun e drogës", u shpreh deputeti. "I bëj thirrje prokurorisë të kërkojë të njëjtën gjë nga presidenti për zbardhjen e mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare", tha Flamur Noka. Deputeti i



PD-së u shpreh se "peshku më i madh" në vendin tonë është Edi Rama dhe sipas tij, drejtësi duhet të bëhet duke filluar nga kryeministri. "Peshq të vegjël janë anëtarët e kabinetit qeveri-

tar. Peshku i madh është edhe Tahiri. Kur kemi thënë qeveri kriminale, nuk e kemi thënë kot. Nuk them se nuk ka pasur edhe më parë, por korrupsion galopant, apo termi Shqipëria

bazë e drogës në Europës, apo Shqipëria 'Kolumbi e Europës', që e thotë DASH, nuk është thënë kurrë më parë. Saimir Tahiri e kish të 0 shansin të bënte gjithë këto batërdira pa pasur mbështetjen e Ramës. Kam qenë vetë ministër i Brendshëm dhe e di se çfarë mund të bëhet nëse nuk ke mbështetje", tha Noka. Sipas tij, "Rama del dhe thotë këtë vit është mbjellë më pak kanabis. Po, sepse i ka ngelur stok. Ndaj nuk mund të mbjellin pa shitur këtë, jo se e luftoi Edi Rama".



Kryetari i PD-së publikon dëshminë: Zyra në Gardë u pastrua

Çështja 'Tahiri', Basha: Rama e Xhafaj zhdukën provat pas denoncimit

Punonjësi i Gardës: Tri automjete u ngarkuan me kuti të mëdha

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje treshen Edi Rama, Fatmir Xhafaj e Saimir Tahirin se kanë zhdukur provat dhe kanë fshehur gjurmët duke mos lejuar prokurorinë të hetojë për çështjen e Saimir Tahirit. Në një postim të tij në rrjetin social "Facebook", kreu i PD-së bëri publik dëshminë e një qytetari, i cili ditë më parë denoncoi faktin se bashkëshortja e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri kishte qëndruar 5 orë në zyrën e Tahirit te Garda e Republikës. "Zoti kryetar, një ditë pasi ju publikuat në 'FB' denoncimin tim për praninë me orë të tëra të Saimir Tahirit dhe zonjës së tij në dy zyrat që Tahiri administron te Garda, kanë ndodhur dy ngjarje: të mërkurën më 8 nëntor në ora 12 në mesditë ka mbërritur një grup drejtuesish të policisë dhe të Gardës, të cilët kanë kontrolluar zyrat. Të nesërmen, ditën e enjte 9 më nëntor, nga ora 9 deri në orën 12, zyrat janë boshatisur tërësisht nga bashkëpunëtorë të Saimir Tahirit, të ndihmuar nga punonjës të policisë dhe të Gardës. Tri automjete janë ngarkuar me kuti të mëdha të mbushura plot: një furgon i bardhë me targë MB 403 AA, një kamioncinë ushtarake me targë MB 019 AA dhe një 'Golf 5' ngjyrë vishnje me targë AA 258 KS. Pasi i boshatisën zyrat, i pastru-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

DENONCIMI

"Ditën e enjte, 9 nëntor, nga ora 9 deri në orën 12 zyrat janë boshatisur tërësisht nga bashkëpunëtorë të Saimir Tahirit të ndihmuar nga punonjës të policisë dhe të Gardës. Tri automjete janë ngarkuar me kuti të mëdha të mbushura plot", thuhet në dëshminë e qytetarit.

an dhe ndryshuan edhe emërtimin në dyert e dy zyrave dhe u larguan. E gjitha kjo ndodhi vetëm një ditë, pasi ju publikuat den-

oncimin tim për ardhjen dhe qëndrimin disaorësh të Tahirit dhe të zonjës së tij në dy zyrat që Tahiri administron te Garda". Ishte kjo

ERJON BRAÇE

Deputeti socialist iu përgjigj dje akuzave të kreut të PD-së, duke i thënë "të ketë turp". "Lulzim Basha është një palaço, një frikacak, që kurrë nuk do ta pranojë suksesin e të ndryshmit, mbi të gjitha, tani nuk do ta pranojë kurrë suksesin e Policisë së Shtetit. Ai nuk e do luftën kundër krimi! Harrojeni!", tha Braçe.

dëshmia që e publikoi dje kreu i PD-së, duke akuzuar për prishje të provave të hetimit kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm. Opozita ka ngritur që në fillim dyshimet e saj për prishjen e provave, që mund të implikojnë ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri në hetimin që po u bëhet anëtarëve të bandës së Habilajve. Emri i ish-ministrit u përmend në përgjimet e publikuara nga media ital-

iane dhe më pas ishte Prokuroria shqiptare, e cila i kërkoi Kuvendit dhënien e autorizimit për marrjen në arrest të deputetit të Partisë Socialiste, Saimir Tahiri. Kjo procedurë në fakt zgjati disa ditë, për shkak se pati një ballafaqim të Tahirit me deputetët anëtarë të Këshillit të Mandateve në Kuvend. E më pas u mbledh seanca e Kuvendit, ku u votua raporti i mazhorancës për t'i dhënë autorizim prokurorisë vetëm për kontroll pasuror, por jo për arrest. Nga ana e saj, opozita këmbënguli edhe në raportin e saj veçmas mazhorancës që Tahiri të arrestohej, por kjo çështje nuk u mbështet në Kuvend. Tashmë, hetimi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda vijon. Pak ditë më parë, një biznesmen në Elbasan iu kapën në makinë edhe dy patenta të Tahirit dhe një e bashkëshortes së tij për drejtim mjetesh lundrimi së bashku me 800 mijë euro. Kjo e ringriti edhe një herë ndjeshmërinë e kësaj çështjeje nga opozita.

URA NË KORDHOC



Tritan Shehu:
Rilindja po hakmerret ndaj Lazaratit

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu akuzoi dje qeverinë se po hakmerret ndaj Lazaratit. Ai shprehet se ura e Kordhocës është e vetmja lidhje e Lazaratit dhe fshatit Kordhocë, ndërsa riparimi i fundit i saj është realizuar dhjetë vite më parë. Shehu tha se fakti që në atë zonë Rilindja mori vetëm një "grushi" votash, duket që është shkak që e ka lënë këtë urë në mëshirën e fatit dhe që po e çon Lazaratin në izolim. "Ura e Kordhocës është e vetmja lidhje e Lazaratit dhe fshatit Kordhocë me fushat e tij. Gjithashtu, një vepër kulturore kjo, e rrallë nga arkitektura e saj, pra me vlera të shumëllojshme, po rrezikon të shembet. Riparimi i fundit i saj është realizuar dhjetë vite më parë. Për ironi, përgjegjëse për mirëmbajtjen e asaj ure është Ministria e Kulturës, drejtuesja e së cilës është edhe deputete e atij qarku", tha Shehu.



Kryeministri sqaron taksën për ujin nga Dibra: Nuk merremi me pusët

Rama: Në administratë ka parazitë, do t'i pastrojmë zyrat e shtetit

"Rrugët në Shqipëri, komplet jashtë standardeve"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje nga Burreli, ku pati një bashkëbisedim me qytetarët se ende në administratën shtetërore ka parazitë, grabitqarë dhe njerëz që i shohin qytetarët nga xhepi. Duke folur për platformën e bashkëqeverisjes me qytetarët, Rama u shpreh se kjo platformë është një mënyrë edhe për të realizuar pastrimin e zyrave të shtetit dhe për të çuar "tepsinë për skrap". Kjo kërkon kohën e vet, sepse të ndërtohet një administratë, sipas Ramës, nuk është një- lloj si të ndërtohet një shtëpi, por kërkon kohë e mund. "Ne jemi të vendosur ta bëjmë - tha Rama. - Nëse bëhemi bashkë, njerëzit nuk pajtohen me rryshfetin dhe vonësën, por menjëherë bëjnë me dije qeverinë mbi problemet. Kjo është një zgjidhje e shpejtë, efi-kase dhe ndihmon që të tjerëve të mos u krijohen probleme nga zyrtari që mban përgjegjësi. Kjo është mënyra se si ne duam të funksionojë platforma", tha Rama. Sipas tij, platforma çon ankesën e çdo shtetasi në tavolinën e ministrit përkatës. "Kjo është në njëfarë mënyre - tha Rama - që çdo qytetar të marrë pushtetin që ka, për ta influencuar qeverinë në funksion të zbatimit të ligjit. Kryeministri theksoi se platforma do t'i vijë në ndihmë edhe biznesit, i cili mund të parashtrijë aty ankesat dhe të marrë zgjidhje nga institucionet përgjegjëse". "Do vazhdojmë të rrisim ndjeshmërinë e qytetarëve dhe do t'i nxisim të bëhen pjesë e koalicionit të madh qeverisës. Një nga hallat më të mëdha në këtë vend është se nuk ndesh në njeriun e duhur në zyrën ku troket, je në det të hapur. Ne po punojmë çdo ditë për ta luftuar dhe zbrapsur, pasi kemi një fenomen të trashëguar të administratës, ku ka shumë parazitë, grabitqarë, njerëz që i shohin qytetarët nga xhepi dhe s'ua kërcet fare kush është përballë", tha Rama.



Kryeministri Edi Rama

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha, i nxitur nga një komentues që e ka pyetur se çfarë investimesh ka bërë për Dibrën, i ka renditur atij listën e investimeve që janë bërë në kohën e qeverisjes së tij. "Në vitet 2005-2013 në qarkun e Dibrës u investuan 490 milionë euro me të cilat janë ndërtuar 800 km rrugë", tha Berisha.

PËRPARIM SPAHIU

"Me këto që po thua e po bën në Bulqizë, vetëm një fjalë kam për ty, sharlatan. Njeri me dije të pakta e të cekëta, që përpiqet të mashtrjë të tjerët duke u hequr si i ditur e i zoti, ose që shfrytëzon mirëbesimin a padijen e të tjerëve, mashtrues i paturpshëm, batakçi. Fraza sharlatanësh", shkroi dje si reagim ndaj kryeministrit, deputeti i LSI-së.



Ervin Bushati: Çekia po heton për CEZ, në Shqipëri çështja mbyllet

Partia Socialiste i kërkoi prokurorisë të mos mbyllë hetimin për çështjen CEZ, duke e konsideruar atë si skandal më i madh i korrupsionit shtetëror. Deputeti i Partisë Socialiste, Ervin Bushati, në një deklaratë për mediat nga selia e Kuvendit deklaroi se prokuroria po kërkon të mbyllet çështja pa kryer asnjë hetim. "Prokuroria minimalisht duhet të kishë marrë deklaratimet e personave të përfshirë në këtë aferë. Si ka mundësi që ka prokurorë që çojnë ndërmend se në Shqipëri në vitin 2017 mund të mbyllet një aferë kaq e madhe korruptive, pa bërë asnjë hetim?", është shprehur Bushati. Gjithashtu, deputeti socialist tha se prokuroria e Çekisë është duke hetuar intërisht kompaninë CEZ, përfshirë edhe transferimin në Shqipëri të rreth 7 milionë eurove, nisur nga raportit i Komisionit Hetimor Parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë. "Këto transaksione nga CEZ në favor të Nue Nik Kalaj, komisionit i kanë krijuar dyshimin e arsyeshëm se kjo shumë është marrë për të ushtruar ndikim të paligjshëm tek ish-funksionarët e lartë të asaj kohe, me qëllim realizimin e blerjes së 76% të aksioneve të OSSH-së nga CEZ", theksoi Bushati.

Edmond Panariti: Të vendosen në veprim komisionet e vetingut

Ish-ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti komentoi situatën politike nga Korça, ku mori pjesë në një aktivitet. "Nuk dua të komentoj për deklaratat e ambasadorëve apo të personaliteteve të tjera të politikës apo diplomacisë. Ajo që dua të theksoj është që ne duhet të vëmë në veprim komisionet e vetingut të verifikimit të figurave të prokurorëve dhe gjyqtarëve - tha ai. - Këto duhen bërë, sepse jemi vonë, pra është humbur kohë shumë e vlefshme. Këtë pret opinionin publik që komisioni i vetingut të fillojë sa më shpejt, në mënyrë që procesi i skanimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfundojë mundësisht brenda këtij viti, në mënyrë që pastaj pse jo të shtrihet edhe në politikën e lartë të Shqipërisë. Këtë pret opinionin publik dhe çdo vonesë nuk i shërben reformës në drejtësi", - tha Panariti. Ndërkohë, ai foli dje edhe për mbylljen e thertoreve, duke u shprehur se mbyllja e tyre i shërben një grushti biznesmenësh.

Studio Perbarimorë "SHKRELA" do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë:
 "Apartament" me sipërfaqe 53.8 m2, me nr. Pasurie 2/189+13-135, Vol. 12, Fq. 125, Zona Kadastrale 8120, e ndodhur ne Rr. "Shqyri Peza", Pall. 6, Shk. 13, Ap. 135, Tirane, ne pronesi te bashkepronareve Sina, dhe e hipotekuar ne favor te bankes.
 Çmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 25,824 (njzete e pese mijë e teteqind e njzete e kater) Euro
 Ankandi i pare zhvillohet me date 17.11.2017, ora 16:00 ne ambientet e Studios Perbarimorë Shkrela me Adrese: Rruga Blv. "Zogu i I", Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.

Petrit Vasili: Rama ligjëron evazionin me taksat, të paditet

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, deklaroi dje, se kryeministri duhet paditur. Në një reagim të tij në lidhje me taksat, Vasili shkroi në rrjetin social "Facebook": "Ky kryeministër, që ligjëron evazionin me taksat, duke shkelur e dhunuar Kushtetutën e duke përbuzur edhe FMN-në, duhet Paditur! Kryeministri dhe qeveria e drogës shkelin Kushtetutën, e cila përcakton prerë se taksat vendosen me ligj. I japin vetes tepsinë për t'i vënë taksat, jo me ligj



të qartë për detyrimin për të paguar taksat që ka secili në këtë vend, por që t'i vërë kryeministri dhe qeveria sipas qejfit dhe kapijes së tyre: ndryshe miqve, klientëve dhe trafikantëve dhe ndryshe bi-

znesive të ndershme dhe korrekte, që duan t'i mbysin dhe t'i falimentojnë. Në realizim e këtij qëllimi të zi përbuzin dhe ato që thotë qartë FMN-në. Kur kanë kurajë të përbuzin dhe FMN-në, imagjnoni ç'i pret njerëzit e thjeshtë", u shpreh dje Vasili. Sipas tij, nën 151 Kushtetutës së Shqipërisë thotë: "Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre, caktohen me ligj".

mall. Do bleh mallin. Por nuk merremi me pusët, as me ato që janë hapur për vaditje, aty ku nuk ka sistem vaditës, se nuk mund t'i u themi njerëzve, mbyllni pusët dhe rriini pa ujë për sa kohë shteti nuk i ka çuar ujë për vaditje. Thjesht, pusët që janë për vaditje duhen regjistruar. Pastaj, në të ardhmen do t'i u takojë ndër marrjeve të ujës jellësit të bëjnë atë që shohin të arsyeshme", tha Rama.

RRUGA E ARBRIT
 Gjatë prezantimit të projektit për Rrugën e Kombit, kryeministri Rama u shpreh

se, "Rruga e Arbrit është shfaqur si premtim, sa herë janë shfaqur këtu politikanët, kur u janë dashur votat dhe është harruar si premtim sa herë kanë mbaruar zgjedhjet, deri kur ne e morëm seriozisht përsipër këtë zotim, me vetëdijen se Rruga e Arbrit nuk është thjesht një rrugë që do lidhë një zonë me një zonë, por është një zhvillim strategjik për ekonominë, për punësimin dhe padyshim për turizmin, që do të sjellë shumë zhvillim dhe shumë punësim në të gjithë këtë zonë". Duke folur

për standardin e ndërtimit të rrugëve, Rama tha: "Për të dhënë një shembull më të thjeshtë, është njësoj sikur rrobaqepësi të më marrë mua masën për një kostum, por masën e mëngëve t'ia marrë Erion Braçes, masën e shpatullave t'ia marrë Mimi Kodhelli dhe unë ta vesh. Edhe pantallonat Bashkim Finos. Kështu janë rrugët e Shqipërisë. Ose u kundërta, t'i qepin Erionit ose Bashkimit kostum me masën time për pantallona. Rrugë komplet jashtë çdo standardi".

Dy ministrat japin sot përfundimet e negociatave, ende asgjë për çamët

Kufiri detar, Bushati-Kotzias bien dakord për një ndarje të re

Ministri shqiptar: Dosje jo e lehtë, është mbi 70-vjeçare

Greçia ka pranuar më në fund se me marrëveshjen për kufirin detar të vitit 2009, Shqipëria humb sovranitetin. Kjo ka dalë nga dita e dytë e takimit mes ministrave të Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministrit grek, Nisko Kotzias në Kretë të Greqisë. "Pala greke ka pranuar se me marrëveshjen e vitit 2009, Shqipëria humb sovranitetin në territor ndaj dhe është rënë dakord që të ketë një ndarje të re. Pikërisht për këtë do të ketë referime të reja në terren, nga të cilat Shqipëria nuk do të humbë asnjë metër katror sipërfaqe", citoi dje "TCH" nga burimet e tij pranë dy ministrave. Të dy ministrat do të kenë sot një deklaratë në lidhje me bisedimet e tyre dyditore. Por, nga ajo që u pa dje, duket se bisedimet kanë ecur mirë. Dreka e djeshme mes ministrave Bushati dhe Kotzias në Kretë e ka treguar këtë klimë mjaft pozitive. Pas kësaj dreke, ministrat bashkë me stafet e tyre janë pritur nga kryetarët e Bashkisë së Lasithit, një lokalitet i ishullit, ku nuk kanë munguar dhe momentet e relaksit dhe vallet e kërcyera në sheshin "Europa", natyrisht nën tingujt e muzikës greke. Duke folur për mediat greke dje, pasdite, ministri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati, tha se bisedimet kanë qenë më intensive dhe të strukturuar. "Unë e kam thënë edhe herë të tjera, kjo është një dosje jo e lehtë, rreth 70 e ca vjeçare, për pasojë



Ministri i Evropës dhe Punëve të Jashtëm, Ditmir Bushati dhe ministri grek, Nisko Kotzias në Kretë të Greqisë

kërkon kohën e vet dhe instrumentet më të përshtatshme për një zgjidhje në frymën europiane dhe bazuar mbi të drejtën ndërkombëtare", u shpreh ministri Bushati. I pyetur nëse ka "tym të bardhë" për ndonjë nga çështjet e diskutuara, ministri Bushati u përgjigj: "Bëhet

fjalë për një paketë çështjesh të hapura, ndonëse çështjet jemi përpjekur për t'i vendosur sipas një tematike të caktuar kohore apo logjike. Për sa kohë do të vazhdojmë në këtë proces konsultimi dhe në këtë proces diskutimi intensiv dhe të imtësishëm me palën greke, do të pëlqejë të jem i

LIGJI I LUFTËS

Për ligjin e luftës, palët kanë sjellë me vete edhe ekspertizën ndërkombëtare, ndërsa pala greke ka hulumtuar me Presidencën për mënyrën ligjore të heqjes së ligjit në fjalë. Për këtë temë ka një shqyrtim të Presidencës greke, e cila ka vlerësuar se heqja e ligjit mund t'i bashkëngjitet traktatit të ri të miqësisë, i cili do të formulohet në muajt në vazhdim.

tohet se ndalesa në Lasith nuk është vetëm simbolike. "Po punojmë me kolegun Bushati, sepse duam që Shqipëria të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian", ka shtuar shefi i diplomacisë helene. Po sipas burimeve, duket se çështja e varrezave të të rënëve të ushtarëve grekë në Luftën e Dytë Botërore do t'i bashkëngjitet listës së çështjeve të mbyllura mes dy vendeve. Pala greke insistoi se bëhet fjalë për një çështje humane, ndaj dhe si e tillë duhet të trajtohet. Për çështjet konsullore tashmë është rënë gjithashtu dakord dhe mbetet për të përfunduar formulën sesi do të aborgohet në praktikë edhe kjo çështje. Për ligjin e luftës ka një shqyrtim të presidencës greke, e cila ka vlerësuar se heqja e ligjit mund t'i bashkëngjitet traktatit të ri të miqësisë, i cili do të formulohet në muajt në vazhdim.

rezervuar dhe i matur në deklaratime". Ndërsa, ministri Kotzias ka deklaruar se janë duke vijuar ende bisedimet për integrimin e Shqipërisë në BE. "Po bisedojmë për tema të cilat janë të hapura dhe duam t'i zgjidhim sot për të parë perspektivën e së nesërme", ka vijuar Kotzias, duke lënë të kuptuar

ISH-MINISTRI

Paskal Milo: Janë rreth 11 mijë ushtarë grekë që

nuk u gjenden eshtrat

Ish-ministri i Jashtëm, Paskal Milo, shpjegoi dje se janë 11 mijë ushtarë grekë, eshtrat e të cilëve nuk gjenden dhe nuk korrespondojnë me të dhënat e palës greke. Duke folur në emisionin "Kapital" të gazetarit Aleksandër Furxhi, ish-ministri i Jashtëm tha: "Nuk janë gjetur të gjitha eshtrat, ka një mosmarrëveshje midis pretendimeve që janë rreth 11 mijë e disa të varrës sipas regjistrave grekë, të cilët nuk janë gjetur të gjithë dhe bëhen përpjekje që të gjenden të gjitha eshtrat ose maksimalisht të gjenden eshtrat e të gjithë ushtarëve të rënë në luftë, por të shmangen keqkuptimet, keqinterpretimet, siç u bë në Kosinë. Atje merreshin eshtra të tjera dhe varrësishin si të ushtarëve grekë. Pikërisht këtu është një aspekt teknik i problemit, se në parim qeveria shqiptare e respekton firmën që ka vënë në këtë marrëveshje, por do garanci që të mos ndodhin ato incidentet e pakëndshme që ndodhën në atë vend", shpjegoi Milo.

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE PRANË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të institucioni i Komisionerëve Publikë", shpall vendet vakante për pozicionet:

Specialist Financë/Buxheti (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

Specialist i Burimeve Njerëzore (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 4 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

Specialist IT (III-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (WordPress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Specialist Protokoll/Arkive (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

2 sekretare pranë Komisionerëve Publikë (kategoria e pagës sipas VKM nr. 187/2017)

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

- Të ketë njohuri shumë të mira të programeve kompjuterike Microsoft Office.
- Eksperienca në punë përbën avantazh.

KUSHTETË PËR GJITHSHMË

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e nenit 6 të ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 20 deri 24 Nëntor, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Godina e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Godina e ish Lidhjes së Shkrimtarëve, Rruga e Kavajës, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27 Nëntor 2017 dhe të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga zyra postare. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf, 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti)
- Dokumentat (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetdeklarim, certifikata, trajnime etj) fotokopje ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (Vërtetim nga Gjykata, Vërtetim nga Prokuroria, Dëshmi e gjendjes gjyqësore)
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Një rekomandim nga punëdhënësi;
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë deponuar dokumenta të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrojnë Komitetit ad-hoc dokumentat e njësuar ose ato origjinale.

Shqyrtimi i dosjeve në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, dokumentet pranohen në "a-Albania"

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ndryshon procedurat për shqyrtimin e dosjes së ish-pronarëve. Përmes një njoftimi zyrtar, ATP bën të ditur se ka kaluar në portalin "e-Albania", aplikimin për ankesë dhe trajtimin e dosjes me specialistin përkatës, si dhe aplikimin për kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes. Me anë të dërgimit 'online' të kërkesës për marrjen e informacionit, vetë Agjencia e Pronave përmes personave përgjegjës, kryen shqyrtimin e kërkesës bashkë me dokumentacionin shoqëruar. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, ajo trajtohet nga specialistët dhe brenda 30 ditësh, qytetari të interesuar i kthehet përgjigjia 'online' përmes e-mail-it si dhe të seksionit "Hapësira ime" në portalin "e-Albania". Në rast se përgjigjia kërkohet edhe në letër, atëherë qytetari duhet të paraqitet fizikisht pranë sporteve të ATP-së. Edhe kur aplikim për kërkesën nuk është sipas rregullave të paracaktuara, sërish njoftimi i qytetarit bëhet me e-mail, duke shmangur çdo lloj keqkuptimi të mundshëm. "Gazeta Shqiptare" zbardh të gjithë procedurën që duhet të ndiqet për aplikim si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen përmes portali qeveritar. Kostoja e aplikimit është 3 mijë lekë, ndërsa afati i shqyrtimit të kërkesës vetëm 30 ditë.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM
Bazuar në VKM nr. 255/2010 "Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës", subjektet e shpronësuar (trashëgimtarët apo përfaqësuesit me prokurë) paraqesin pranë ATP-së, Tiranë (përvëç kërkesës për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës) dhe dokumentacionin e nevojshëm. Bazuar në VKM nr. 255/2010

Ish-pronarët, ATP ndryshon procedurat për kompensim

Kostoja e aplikimit 3 mijë lekë, afati 30 ditë



KËRKESË PËR STATUSIN DHE PROBLEMATIKAT E SHQYRTIMIT TË DOSJES
Shërbim elektronik "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë online kërkesën për të marrë informacion në lidhje me eurinë e shqyrtimit të dosjeve të ndjekura nga Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP). Pas dërgimit të aplikimit, specialisti i Zyrës Juridike, pranë ATP-së bën shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqëruar nëse ka. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, specialisti përpilon përgjigjen për kërkesën e aplikantit dhe ia dërgon me e-mail, si dhe tek "Hapësira ime" në seksionin "Dokumentet e mia" në portalin "e-Albania". Nëse përgjigjia është kërkuar edhe në formatin letër, atëherë ai njohetohet se duhet të paraqitet pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për ta tërhequr atë. Në rastin kur aplikim nuk është i rregullt dhe nuk pranohet, aplikant njohetohet për këtë fakt me anë të e-mail.
DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM
1. Dokument identifikimi, kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për tu loguar në portal).
2. Formuluar i aplikimit për informim në lidhje me eurinë e dosjes.
3. Dokumentacioni shtesë, nëse është e nevojshme.
HAPAT E PROCEDURËS
1. Logohuni si qytetar në portalin "e-Albania".
2. Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes".
3. Plotësoni të dhënat e formularit, duke bashkëngjitur dhe dokumente plotësuese, nëse është e nevojshme.
4. Klikoni butonin "Dërgo".
5. Specialisti i Zyrës Juridike bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyrë dixhitale ose me postë në hard copy, në varësi të kërkesës së aplikantit.
Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 30 ditë.

"Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës" subjektet e shpronësuar (trashëgimtarët apo përfaqësuesit me prokurë) paraqesin pranë ATP-së, Tiranë (përvëç kërkesës për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës) dhe dokumentacionin e nevojshëm.

DOKUMENTACIONI

- Kërkesë sipas Formularit-Tip (për subjektet që deponojnë kërkesa të reja sipas vendimit të gjykatës për rivendosje në afat).
- Kërkesa nënshkruhet nga subjekti i shpronësuar apo nga përfaqësuesi me prokurë.
- Mandatpagesë për shqyrtimin e kërkesës (për subjektet që deponojnë kërkesa të reja).
- Dëshmit trashëgimie, në rast se subjekti i shpronësuar ka vdekur.
- Dokument identifikimi i subjektit të shpronësuar apo përfaqësuesit me prokurë.
Dokument ligjor: (një ose më shumë nga të poshtëshënuarit me përjashtim të pikës c):
1. Vërtetim pronësie, i shoqëruar me një kopje të fletës përkatëse të regjistrimit hipotekor, lëshuar nga ZVRPP për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronës.
2. Dokumentin kadastral, shoqëruar me një kopje të fletës përkatëse të regjistrimit kadastral nga zyra e administrimit dhe matrojtjes së tokës në qark.
3. Vendim gjyqësor i formës së prerë së bashku me hartën e pasurisë të vullosura me vlerën e gjykatës dhe të shoqëruar me akt ekspertim përkatës, në rast se gjatë gjyqimit të çështjes është kryer një i tillë.
4. Dokument që vërteton shpronësimin, shtetëzimin apo konfiskimin e pronës së subjektit të shpronësuar, sipas akteve ligjore e nënligjore, vendime penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë që nga data 29.11.1944, apo dokumenti për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë të krijuara para datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr. 37, datë 13.01.1945 "Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës".
5. Vendimet e mëparshme të ish-KKKP të marra sipas ligjeve: nr. 7698, dt.15.04.1993, ose nr. 7699, dt. 21.04.1993, dhe nr. 9235, dt. 29.07.2004, të cilat janë marre para hyrjes në fuqi të ligjit 9583, dt.17.07.2006, të ndryshuar.
6. Dokument i lëshuar nga Arkiva e Shtetit në rastet kur dokumentet hipotekore apo kadastrale apo të shpronësimit janë të deponuara tek ky institucion apo çdo dokument tjetër i lëshuar nga institucionet shtetërore, që kanë vlerë provuese për hetimin administrativ të çështjes.
7. Dokument lëshuar nga arkiva hipotekore, që ndodhen pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe çdo dokument tjetër ligjor i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
Dokument hartografik për pozicionimin gjeografik të pronës, i cili sipas rastit përmbledhet:
1. Dokument hartografik të mëparshëm, që i takon kohës nga fitimi i të drejtës së pronësisë deri në marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.
2. Dokument hartografik aktual, i cili përmban të dhëna topografike mbi pronën e pretenduar, i konfirmuar nga institucioni që e lëshon atë.
Në çdo rast që subjekti deponon kërkesë të re, sipas një vendimi gjyqësor për rivendosje në afat, pjesë e dokumentacionit shoqëruar është edhe vendimi i gjykatës për rivendosjen në afat.
Hapat e procedurës
1. Subjekti i shpronësuar deponon drejtpërdrejt ose me postë në ATP kërkesën për njohjen/kthimin apo kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e lartpërmendur.
2. Kërkesa e subjektit të shpronësuar duhet të jetë sipas formularit-tip, të miratuar nga ministri i Drejtësisë, me pozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, (ky formular gjendet në uebsitin zyrtar të ATP-së).
3. ATP-ja pranohet të administrojë kërkesat e subjekteve të shpronësuar kundrejt tarifave të përcaktuara, me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave.
4. Në rastet kur ATP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes së njoftimit për plotësim dokumentacioni.
5. Kërkesat e subjekteve të shpronësuar, të cilat deponohen nëpërmjet shërbimit postar dhe kanë mangësi në dokumentacionin shoqëruar, do t'i kthehen kërkuarit në adresën e dhënë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit sipas dispozitave të VKM nr. 255/2010. Kërkesa, së cilës i mungon adresa e saktë postare, vlerësohet jo e mirëqenë dhe riaktivizohet vetëm me interesimin e kërkuarit pranë zyrave të ATP-së. Në çastin e konstatimit nga struktura përkatëse e ATP-së, bëhet shpallja publike në mjediset e ATP-së dhe në njesitë e qeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi. Kërkesa e subjektit të interesuar pranohet brenda një afati 3-mujor nga data e konstatimit, në të kundërt kërkesa e subjektit nuk pranohet, me vendim të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së.
6. Dosja/kërkesa qëndron në sektorin e shqyrtimit deri në plotësimin e plotë të dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar, por jo më shumë se 30 ditë nga data kur subjekti titullar i dosjes ka marrë dënim për mangësitë e saj. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar, propozohet marrja e një vendimi në gjendjen që janë aktet.
7. Të gjitha kërkesat për njohje dhe kthim të pronës, në zyrat e ATP-së shqyrtohen sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre në ish-ZRRKP apo ATP Tiranë.
8. ATP-ja, pas shqyrtimit të kërkesës merr një vendim për dosjen/kërkesën për pranimin/rrëzimin e plotë të pjesëshëm të saj.
9. Në çdo rast ATP-ja i dërgon me postë subjektit një kopje të vendimit të saj.
Kosto:
3,000 lekë - kërkesë për shqyrtim.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **5,680,000 Lekë**. Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraparakistet pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e disa pajisjeve pune për përpunimin e parasë dhe letër fashetimi e shirit plastik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **05 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGISJË
NJOFTIM PËR LIÇENSIM

Në zbatim të nenit 40, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të nenit 18 të "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave" të ERE-s, të nenit 10 të "Rregullores për Procedurat e Liçensimit Modifikimit, Transferimit të Plote/ të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave", bëjmë me dije të gjithë personat, Institucionet ose shoqëritë e interesuara se: shoqëria "Prima Energy" sh.p.k., ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për tu liçensuar, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

Me vendimin nr.185, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s, ka filluar procedurat e liçencimit të këtij subjekti në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

Të gjithë të interesuarit lidhur me këtë vendim, mund të paraqisin objeksionet e tyre, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit, pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi "Barjam Curri"; Rruga: Viktor Eftimu Tiranë.

Adresa: Bulevardi "Barjam Curri"
Rruga, Viktor Eftimu, Tiranë
E-mail: eral@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al

Prokuroria: Kemi tri prova, që nga pamjet filmike, SMS-të në "Whatsapp" dhe telefonatat

TIRANË

Dy ditë pas arrestimit të gjyqtarit të Apelit të Tiranës, Shkëlqim Miri, "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" kanë mësuar identitetin e ndërmjetësit për të ndryshuar masën e dënimit për Gentian Dodën, nga "vrasje" në "plagosje të rëndë me dashje". Mësohet se ndërmjetësi ka qenë kushëriri i Dodës, Alban Buci, ndaj të cilit është prerë fletë-arresti. Mësohet se Buci është një nga ndërmjetësit që i dorëzoi paratë Kujtim Miri, i cili kushëririt të gjyqtarit, i cili gjithashtu ka përfunduar në pranga. Burime nga Prokuroria e Krimeve të Rënda pohuan se kanë në dorë pamjet filmike të një kamere sigurie në Fushë-Krujë. Në këto pamje duket sekseri, i cili merr 20 mijë euro nga një i afërm i Gentian Dodës. Burimet konfirmojnë se në këto pamje është njëri prej seksërëve, Kujtim Miri ose Alban Buci. Ndërkohë, prokuroria ka dorëzuar dje kërkesën për masën e arrestit me burg për gjyqtarin në fjalë, i cili u kap në kuadër të hetimit për marrjen e 20 mijë eurove në këmbim të lirimit të të dënuarit për vrasje, Gentian Doda. Në shtëpinë e 46-vjeçarit Miri gjatë kontrollit të policisë u gjet një shumë monetare me vlerë 300 milionë lekë të vjetra. Sipas burimeve policore, paratë ishin fshehur mes rrobave të fëmijëve. Ai rrezikon një dënim nga 5 deri në 12 vjet burg, nëse shpallet fajtor, në bazë të akuzës për

Ja miku i Gentian Dodës, që "fundosi" gjyqtarin e Apelit, Shkëlqim Miri

Alban Buci, një nga ndërmjetësit që i dorëzoi 20.000 euro Kujtim Miri, kushëririn të 46-vjeçarit Miri



Gjyqtari i Apelit, Shkëlqim Miri

korrupsion pasiv të ngritur nga organi i akuzës. **HETIMI** Burime zyrtare nga prokuroria bëjnë me dije se gjyqtari Shkëlqim Miri hetohej prej afro një viti, pasi dyshohet të ketë favorizuar

të dënuarin Gentian Doda. Hetuesit dyshonin se ky i fundit ka paguar një shumë lekësh për gjykatësin që ndryshoi kualifikimin e vrasjes së Gazmir Dedjas në Burrel, në vitin 1997, nga vrasje, në plagosje e rëndë

me dashje. Po të njëjtat burime u shprehën se pjesë e afërës korruptive janë edhe katër persona të tjerë, që nga ndërmjetësi deri tek një i afërm i Dodës, i cili para disa muajsh ka fituar lirimin. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka në dorë tri prova që implikojnë gjyqtarin Shkëlqim Miri në marrjen e 20 mijë eurove për t'i ndryshuar akuzën Gentian Dodës. Përveçse pamjeve filmike të një kamere sigurie në një lokal në Fushë-Krujë (në maj të këtij viti) ku shfaqet ndërmjetësi duke marrë paratë, organi i akuzës ka edhe një provë tjetër. Bëhet fjalë për mesazhet përmes aplikacionit "Whatsapp". Pas marrjes së 20 mijë eurove, Gentian Doda merr një mesazh në "Whatsapp", ku i thuhet se, "çështja do rregullohet brenda disa javësh". Mesazhi i

është dërguar Dodës nga një tjetër i dyshuar, që kishte dënuar për dhënie e lekëve. Prokuroria ka improvizuar sekuestrimin provizor të këtij celulari, për të marrë mesazhet, duke i thënë personit në fjalë se celulari dyshohej si i vjedhur. Pas marrjes së komunikimit me Gentian Dodën, celulari i është rikthyer brenda disa orësh personit në fjalë. Por prova më e rëndësishme që kanë në dorë hetuesit e çështjes janë edhe disa tabulate telefonike dhe mesazhe të gjyqtarit Shkëlqim Miri. Ky i fundi ka komunikuar në telefon me kushëririn e tij, Kujtim Miri dhe sekserin Alban Buci. Ende nuk dihet përmbajtja e këtyre komunikimeve, por burimet theksojnë se ato lidhen pikërisht me marrjen e 20 mijë eurove, për t'i ndryshuar akuzën Dodës nga "vrasje" në "plagosje të rëndë me dashje".

SHKURT

Mermeri bie nga trajtleri në makinë, vdes e reja, plagosen 3 familjarët

LUSHNJË - Një 24-vjeçarë humbi jetën dhe 3 familjarët e saj mbeten të plagosur, pasi një pllakë mermeri u shkëput nga një trajtler dhe ra mbi makinën ku ata udhëtonin. Ngjarja ndodhi paraditen e djeshme në aksin Lushnjë-Berat, në afërsi të fshatit Çiflig. Mësohet se viktima është Erinolda Isufaj, ndërsa prindërit e saj Vitori e Shkëlqim Isufaj, si dhe bashkëshorti Mariko Idri. 29 vjeçarë janë jashtë rrezikut për jetën. Sipas bluve, makina tip "Peugeot", me të cilin po udhëtonin 4 personat është shkatërruar plotësisht, pasi u zu poshtë nga mermeri. Për nxjerrjen e të plagosurve nga autotuveta u desh ndërhyrja e ekipeve të specializuara. Pënjehërerë pas aksidentit, policia arrestoi Bashkim Pulën, 41 vjeç nga Fushë-Kruja, i cili drejtoonte autotmetin që transportonte gurë mermeri.

Plagosi me thikë vëllain dhe kunatën, arrestohet 35-vjeçari

ELBASAN - Një krim i rëndë në familje ka tronditur Elbasanin. Sipas policisë, një 35-vjeçar ka plagosur me thikë vëllain dhe kunatën e tij. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në lagjen "Brigada 17 Sulmuese" të këtij qyteti. Mësohet se pas një konflikti të momentit me familjarët, Altin Illiu ka goditur me thikë vëllain e tij G.L., 43 vjeç dhe kunatën e tij M.L., 39 vjeç. Pas sinjalizimit për ngjarjen, blutë arrestuan agresorin. Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprime të mëtejshme për veprat penale: "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

Eksploziv në banesën e kryebashkiakut Rizvani, prangoset 37-vjeçari

MAT - Mbrëmjen e së premtes, policia e Matit ka vënë në pranga 37-vjeçarin Elton Daçi, pasi dyshohet se është autor i dy ngjarjeve të fundit me lëndë shpërthyes në Burrel. Sipas bluve, Daçi u kap për akuzën e shkatërrimit të pronës dhe mbajtjes së lëndëve plasëse. Shkak për vendosjen e ekspozivit në banesën e kryebashkiakut Nezir Rizvani (më 4 nëntor të këtij viti) dyshohet se është bërë një konflikt për dhënie e një tenderi në bashki. Po ashtu, Daçi akuzohet edhe si autor i shpërthimit në oborrin e një mobilierie më 25 tetor. Më parë Daçi kërkohet edhe për akuzat e "Kanosjes për shkak të detyrës" dhe "Prodhim dhe shitje të narkotikëve".

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha ka publikuar emrin e personit që i dha makinën Orest Sotës, biznesmenit 25-vjeçar, i cili u arrestua nga policia e Elbasanit në makinë me 863 mijë euro dhe dy leje drejtimi në emër të ish-ministrit Saimir Tahiri. Berisha tregon se një gazetari investigativ ka gjetur pronarin e autometit me të cilën udhëtonte Sota me datë 1 nëntor, ditën kur u ndalua nga policia. Sipas tij, makina është në pronësi të Armand Lilos. "Pronari i makinës së krim-it ishte ndërtuesi i klientelës qeveritare, Armand Lilo, me precedent plagosjen e djalit të pronarit ku ai po ndërton", - shkruan Berisha në rrjetin social "Facebook".

POSTIMI I PLOTË
Ja ndërtuesi i klientelës që i dha makinën për transportin e krim-it dhe bandës së Orest Sotës. Të dashur miq, gazetari investigativ ka gjetur pronarin e makinës, me të cilën udhëtonte Orest Sota, që u ndalua nga policia në Elbasan, duke pasur në makinë miliona euro, dy patenta të Saimir Trafikut dhe Florian Habilajn, shoferin e Saimirit, të cilët u larguan me mbrojtjen e policisë, duke marrë me vete secilin nga dy çanta të mëdha plotë euro. Pronari i makinës së krim-it ishte ndërtuesi i klientelës qeveritare, Armand

"Pronari i mjetit, ndërtuesi i klientelës qeveritare, Armand Lilo"

Berisha: Ja cili është personi që i dha biznesmenit Sota makinën, ku u gjetën dy patentat e Tahirit



Lilo, me precedent plagosjen e djalit të pronarit ku ai po ndërton etj. Lexoni shkrimin e gazetarit investigativ. Sb. **Hulumtim/Lidhjet e tjera të Sotës, zbulohet kush është pronari i "Range Rover"-it** Për Orest Sotën është thënë gjithçka, lidhjet e tij të mundshme me Saimir Tahirin, kompania e ndërtimit, marrja e tenderit si nënkontraktor të komisarariatit 6, por edhe jeta e tij private, udhëtimet dhe shpejtësia në timon. Por, tashmë një detaj i ri del për "timonin". Megjithatë Orest Sota është që prej datës 1 nëntor i arrestuar për 3 vepra penale, asnjëherë nuk u bë me dije se

kryeqytet, Armand Lilo. Kompanitë e tij, objekt të aktivitetit kanë zbatimin, projektin të ndërtimeve civile, ekonomike, punime dheu, sistemin të terracave, prodhimet elementë të parafabrikuara, betoni e beton arme, ndërtime civile e turistike, rrugësh, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karperterie, investime në sektorin e energjetikës. Por se çfarë i lidh konkretisht dy biznesmenët përveç makinës, kjo ende është një enigmë, për të cilën prokuroria po punon për ta zbardhur. Kompania e Lilos ndërton kompleksin e pallateve tek ish-"Parku i Autobusëve" Armand Lilo është pronari i kompanisë, e cila filloi ndërtimin e një kompleksi pallatesh pranë policisë bashkiakë në kryeqytet në shtator. Nisja e punimeve u bë shkak që dhjetëra banorë të protestonin për prishjen e lulishtes ku po ngrihen pallatat. Leja e ndërtimit është dhënë në datë 21 shkurt 2017

POLICIA E TIRANËS 2013
30 maj 2013 - plagos djalin e pronarit të truallit, pranga ndërtuesit Armand Lilo

Shpallet në kërkim edhe një tjetër. Policia: Kanabisi erdhi nga Vlora, do transportohej me skaf në Itali

Sekuestrohen 1.5 tonë drogë në Velipojë, 7 në pranga

Një nga të arrestuarit, polic, vëllai i zëvendëskomandantit të kufirit

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Reth 1.5 tonë kanabis sativa që ishte bërë gati për t'u transportuar me skafë nga plazhi i Velipojës drejt Italisë është sekuestruar në orët e para të mëngjesit nga policia e Shkodrës. Mësohet se sasia e madhe e lëndës narkotike, e paketuar dhe e gatshme për transport, u sekuestrua në pjesën fundore të plazhit të Velipojës e njohur si Viluni, në një prej hoteleve të zonës që është afër me bregun e detit. Gjatë operacionit antidrogë janë arrestuar 7 persona, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. Burime zyrtare nga policia e qytetit verior bënë me dije se njëri nga të arrestuarit është efektiv policie. Bëhet fjalë për shtetasin Enriko Zyle, punonjës policie në Drejtorinë e Kufirit dhe të Migracionit Tiranë, vëllai i zvkomandantit të kufirit në Shkodër, Ndrek Zylja (ky i fundit nuk është i implikuar në këtë ngjarje). Sipas bluve, dyshohet se 42-vjeçari kishte rolin e ndërmjetësit dhe se shërbente si siguri (garant) për grupin e trafikantëve. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, burimet e mësipërme deklaruan se droga u transportua nga Vlora dhe se mbrëmjen e së premtes ka mbërritur në Shkodër me destinacion Italinë.

OPERACIONI ANTIDROGË

Reth orës 02:45 të së shtunës, në vendin e quajtur Plazh, Velipojë, policia e Shkodrës ka zhvilluar operacionin e koduar "Viluni Beach". Burime nga ky dikaster pohuan se policia ka rënë në mënyrë rastësore në gjurmët e grupit të trafikut të drogës. Një makinë që po lëvizte në afërsi të Vilunit ka tërhequr vëmendjen e një patrulle të postës së policisë të Velipojës, e cila i është vënë pas. Mjeti tip "Mercedes Benz" është futur në oborrin e hotelit në pronësi të Petrit Vuksanit, rezident në Itali. Mësohet se në një automjet furgon me targa AA 386 CE, në përdorim të 20-vjeçarit Jaho Berdo nga Orikumi i Vlorës u gjet një sasi kanabisi, ndërsa pjesa tjetër, brenda hotelit në pronësi të Vuksanit, i cili në komunikim me policinë është shprehur se hotelin ia ka lënë shtetasit Sokol Ujka për ta administruar. Kontrolli ka vijuar edhe në ambientet e këtij hoteli, ku në katin e parë të tij është konstatuar një sasi tjetër lënde narko-



Një nga të arrestuarit gjatë operacionit antidrogë



Droga e sekuestruar në Velipojë

FORCAT OPERACIONALE

Kreu i Policisë së Shkodrës, Gjovalin Loka deklaroi dje se operacioni u realizua nga drejtoria në varësi të tij, por burime për "GSH" pohuan se ishin Forcat Operacionale nga Tirana që bënë të mundur shkatërrimin e grupit kriminal. Mësohet se Forcat Operacionale u kanë thënë policëve të patrullës së Shkodrës që të ruajnë furgonin, pasi ka disa hajdutë. Në momentin që droga po shkarkohej nga furgoni për në bodrumin e hotelit në Vilun, ndërhyrën forcat nga Tirana.

Droga në Velipojë, Basha: Polici i arrestuar është dënuar në Itali, mbrohej nga Habilajt

TIRANË - Pas sekuestrimit të mbi 1.5 tonë kanabis në Velipojë dhe arrestimit të disa personave, mes të cilëve edhe policin Enriko Zyle, ka reaguar kreu i PD-së, Lulzim Basha. Përmes një statusi në "Facebook" duke iu referuar burimeve, Basha thotë se Enriko Zyle, i cili është vëllai i zvshefit të Kufirit në Shkodër rezultoi se është dënuar në Itali dhe se mbrohej nga Habilajt kur ishte Saimir Tahiri ministër.

Statusi i Lulzim Bashës:

R A M A - T A H I R I - XHAF A E K A N E M B U S H - U R P O L I C I N E M E T R A F I - K A N T E D R O G E

Burime të sigurta in-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

formojnë se: "Prel Enriko Zyla ka qenë i dënuar për trafik dhe shpërndarje droge në Romë, Itali dhe ka vuajtur dënimin në burgun e Rebibbias. Partnerët e kanë ngritur disa herë këtë çështje, por personi ashtu si

shumë të inkriminuar të tjerë në polici mbrohej nga Habilajt në kohën e Tahirit dhe pas ardhjes së Fatmir Xhafës kaloi nën mbrojtjen dhe shërbimin e vëllait të Xhafës, Agronit".

policisë, Enriko Zyle, i cili në përpjekje për t'u larguar nga shpejtësia ka humbur kontrollin e mjetit dhe për pasojë është batur jashtë rrugë. Ai

është prangosur në Bërdicë. Nga hetimet paraprake të kryera rezultoi se ky punonjës policie është i implikuar në këtë veprimtari krimina-

OPERACIONI ANTIDROGË NË VELIPOJË

TË ARRESTUAR

1. Sokol Ujka, 42 vjeç, banues në Velipojë Shkodër.
2. Enriko Zyle, 42 vjeç, lindur në Shkodër banues në Tiranë, punonjës Policie në DRKM Tiranë.
3. Arbër Bozhanaj, 30 vjeç, banues në Orikum Vlorë.
4. Genti Dano, 35 vjeç, banues në Selenicë Vlorë.
5. Dervish Gjolekaj, 32 vjeç, banues në Dukat Vlorë.
6. Jaho Berdo, 20 vjeç, banues në Orikum Vlorë (kishte patentë skafi)
7. Fatjon Merko, 32 vjeç, banues në Përmët.

NË KËRKIM

1. Govalin Ndoj, 44 vjeç, banues në Lezhë.

le. Në automjetin që drejtohej nga punonjësi i policisë ka mundur të largohet 44-vjeçari Gjovalin Ndoj, banues në Lezhë. Në përfundim të peshimit rezultoi se pesha totale e lëndës narkotike të sekuestruar është 1502 kg. Në përfundim të veprimeve të para hetimore të kryera në bashkëpunim me SH.C.B.A, janë arrestuar në flagrancë shtetasit: Sokol Ujka, Enriko Zyle, Arbër Bozhanaj, 30 vjeç; banues në Orikum Vlorë; Genti Dano, 35 vjeç; banues në Selenicë, Vlorë; Dervish Gjolekaj, 32 vjeç; banues në Dukat Vlorë;

Jaho Berdo dhe Fatjon Merko. Ndërkaq, vijon puna për arrestimin e të kërkuarit Govalin Ndoj. Në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda po punohet për dokumentimin e plotë ligjor të këtij aktiviteti kriminal, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve të tjerë, të dyshuar si të implikuar në këtë ngjarje. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë".

U dënuar në Itali me 6.10 vjet burg për trafik lëndësh narkotike, FNSH prangos 45-vjeçarin

ELBASAN - Një 45-vjeçar i kërkuar prej vitesh nga drejtësia italiane është vënë në pranga nga policia e Elbasanit. Kanë qenë forcat speciale që kanë organizuar operacionin për kapjen e tij. Bëhet fjalë për Afrim Tarellin, që ishte dënuar me 6 vjet e 10 muaj burg për veprën penale "Trafikimi të narkotikëve, kryer në bash-

këpunim". Ndalimi i tij u bë me qëllim ekstradimi në shtetin italian. "FNSH Tiranë në bashkëpunim me specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative, bënë

kapjen e shtetasit në kërkim ndërkombëtar, Afrim Tarelli (Zeneli), 45 vjeç banues në Elbasan. Kapja dhe ndalimi i tij u bë, pasi shtetasi i lartpërmendur është shpallur në kërkim nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana më datë 25.03.2014, pasi

Gjykata e Apelit, Torino, me vendim të datës 22.04.2011, e ka dënuar me 6 vjet e 10 muaj burg për veprën penale "Trafikimi të narkotikëve kryer në bashkëpunim". Ndalimi i tij u bë me qëllim ekstradimi në shtetin italian", thuhet në njoftimin e policisë.

Alket Hatija: Nuk kam bunker në Berat, shkoj tek varri i babait, apo tek të afërmit

"Zoti i drogës": Lidhja ime me bandat e trafikut të heroinës

"Vetë nuk dorëzohem, le të më kapë policia"

Në mediat italiane shkruihet se ai trafikoi vetëm në një vit, 350 kg heroinë dhe 190 kg kokainë. Alket Hatija, njeriu që cilësohet nga mediat italiane si "Zoti i drogës", foli dhe në një tërëzim ekskluziv për emisionin "Kjo javë" të moderatorës Nisida Tufa, në "News 24". Nga baza ku fshihet, ai pranon për gazetaren Klodiana Lala, rolin e tij në grupin italo-shqiptar të trafikut të heroinës, ndërsa flet edhe për akuzat dhe vitet e burgut në Shqipëri. Për herë të parë 40-vjeçari, baba i dy vajzave tregon për vilën me bunker në Berat, prapaskanat e ekstradimit drejt Italisë dhe përse nuk pranon t'u dorëzohet autoriteteve. Hatija është dënuar me 20 vite burg në Itali, si pjesë e trafikut të drogës dhe pjesëmarrje në bandë kriminale.

INTERVISTA
Klodiana Lala: Alket kur filluan problemet tuaja me drejtësinë?

Alket Hatija: Në vitin 2008, në 10 shtator të vitit 2008.

Klodiana Lala: Çfarë ndodhi asokohe?

Alket Hatija: Ka ardhur policia më ka kapur me një bujë e madhe për llogari të Italisë. U morëm, shkuam në gjykatë në polici, nga policia na dhanë masën e arrestit. Që nga momenti i masës së arrestit unë kam kërkuar personalisht ekstradimin tim në Itali.

Klodiana Lala: Çfarë ndodhi, u ekstraduat apo pati një gjykim ndaj jush në Shqipëri?

Alket Hatija: Në momentin që unë kërkoja gjykim, si në masën e arrestit, si në apelimin e masës së arrestit, prokurori thoshte që "jo, ju nuk do të shkoni në Itali, sepse ne kemi marrëveshje. Dënimi që do kryhet këtu, është i vlefshëm edhe në Itali.

Klodiana Lala: Pati një gjykim ndaj jush dhe sa u dënuat në përfundim të tij?

Alket Hatija: Në përfundim gjykimi ka shkuar, jemi arrestuar në 2008 dhe gjykimi ka mbaruar në maj të 2010, afërsisht dy vjet, pasi është hetuar dosja. Është hetuar dhe ka dalë në konkluzionin se këta persona janë të njëjtët persona që gjykohen për të njëjtin fakt në Itali dhe do marrin dënimin këtu. Jam dënuar 16 vjet.

Klodiana Lala: Sa kohë qëndruat në burg?

Alket Hatija: Kam pranuar të gjitha në kohën e gjykimit, i kemi pranuar të gjitha çka pasur dosja brenda, me faj, pa faj që shumë gjëra nuk mund t'i kem bërë unë. Po unë prapë i pranova për efekt të gjykimit të shkurtuar, se nuk kishim rrugë tjetër ç'të bënim. Në Itali nuk na çonin të gjykohehim. Ne kemi këmbëngulur deri në Gjykatën Kushtetuese dhe përfundimisht gjykata ka dhënë që është



Alket Hatija



HATIJA

Kam që në '93 që kam ikur nga Berati dhe mund të kem shkuar një herë në vit, i ka rënë apo s'i ka rënë. Shkoj më tepër të varri i babait dhe për ata njerëzit e afërt që kam atje. Po jo të rri me vila, të rri me armë. Po si ka mundësi kur ata më thonë mua je 'zoti i drogës', kur paskam kaq para pse të rri në bunker unë si qen?

Nga "detyrim paraqitje", tek masa "arrest me burg"

Ndonëse Alket Hatija u arrestua në një operacion në Berat, Gjykata e Shkallës së Parë në Durrës e liroi më 11 korrik dhe vendosi detyrim paraqitjeje për 45-vjeçarin. Fill pas kësaj, organi i akuzës iu drejtua Gjykatës së Apelit Durrës, duke kërkuar riarrestimin e të akuzuarit në pritje të ekstradimit të tij në Itali, për të vuajtur dënimin me 20 vite burg, të marrë për trafikim droge dhe pjesëmarrje në bandë kriminale. Në ankimimin e saj, Prokuroria e Durrësit argumentoi se vendimi i Shkallës së Parë, që vendosi lirin e menjëhershëm të 45-vjeçarit, është i padrejtë dhe në kundërshtim me aktet ligjore që rregullojnë këtë aspekt ndërmjet shteteve në procesin penal. Në këto kushte, Gjykata e Apelit vendosi si masë sigurie atë të "arrestit në burg" për "baronin e drogës", i cili akuzohet nga autoritetet



Gjykata e Durrësit

italiane për trafikimin e 350 kilogramëve heroinë. Gjykata e Apelit i kërkoi policisë arrestimin e 45-vjeçarit, por ai nuk gjendej më në

banesën e tij. Gjykata e Shkallës së Parë në Durrës e argumentoi lirin e Hatijes, mbështetur në kërkesën e avokatit të të akuzuarit, si

ANKIMIMI

Prokuroria e Durrësit argumentoi se vendimi i Shkallës së Parë, që vendosi lirin e menjëhershëm të 45-vjeçarit, është i padrejtë dhe në kundërshtim me aktet ligjore që rregullojnë këtë aspekt ndërmjet shteteve në procesin penal.

pas të cilit 45-vjeçari ishte dënua një herë më parë në Shqipëri për këtë veprë me të njëjtat fakte, dënim të cilitin e ka shlyer. Hatija rezul-

ton se është dënua në vitin 2008 dhe më pas është liruar në vitin 2014, pas pretendimeve se bashkëshortja i vuante nga sëmundje kronike. Sipas autoriteteve italiane, Alket Hatija është një nga bosët më të mëdhenj të trafikut të drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Ai ishte shpallur prej vitesh person në kërkim, por për të kishte shumë pak të dhëna. Mësohet se për herë të parë Hatija mbërriti në Itali në vitin 1997. Ai jetonte në komunën Campomarino, në provincën e Campobassos, në një banesë në rrugën "Kennedy", ku kishte punuar për pak kohë në bujqësi. Policia italiane ka vërtetuar se nga janari i vitit 2003 deri në mars të 2004-ës, Alket Hatija kishte trafikuar në 59 raste në qytetin e Milanos rreth 350 kg heroinë e 190 kg kokainë me vlerë 35-40 milionë euro.

dënim legjitim dhe sipas konventës që kemi me Italinë, gjykata ka dhënë që është i ligjshëm edhe për shtetin italian.

Klodiana Lala: Burime

jo zyrtare brenda Policisë së Shtetit thanë që ju jeni pronar i një vile me bunker nëntokësor, që ruhet nga roje të armatosura. Në fakt a keni ju në pronësi një vilë

në qytetin e Beratit?

Alket Hatija: Kam që në '93 që kam ikur nga Berati dhe mund të kem shkuar një herë në vit, i ka rënë apo s'i ka rënë. Shkoj më tepër të varri i ba-

bait dhe për ata njerëzit e afërt që kam atje. Po jo të rri me vila, të rri me armë. Po si ka mundësi kur ata më thonë mua je 'zoti i drogës', kur paskam kaq para pse të rri në

bunker unë si qen?

Unë vetë nuk dorëzohem, policia le të më kapë.

Klodiana Lala: Pse?

Alket Hatija: Sepse nuk kam besim.

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targar

Ornela Manjani

Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

Janë 140 mijë automjete që përfshihen nga falja

Drejtorja e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfutur nga amnistia...

ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/

shuarjes së detyrimeve. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligut 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet/personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

FSHIRJA E DETYRIMEVE

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota, thuhet në njoftim DPSHTRR.

TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

Table with 15 columns containing license plate numbers (e.g., AA019, AA019AL, AA020AF) and corresponding vehicle identification numbers (VINs).

(vijon)

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda një muaji për këstin e parë

Ish-të përndjekurit, 1000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhën e ish-të përndjekurve politike, që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri, duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë joparësore, për trashëgimtarët, rreth 1000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, si përfituesit e kështit të parë. Dokumentet për trajtimin

me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda një muaji.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbas

shit në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, emër/mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet

meoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar

nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vëlljen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të peri-

udhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve, të cilët nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E PARË

(Vijon nga numri i djeshëm)

Shënimi: Kur dokumentacioni është i rreptshëm shënohet me X, kur kanë autorizuar me produkt shënohet me P, ndryshe i dokumentat.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 20225, ARIF, DODA, SULLEMAN, HANE, SULLEMAN, HANE, BESHIR, SULLEMAN, DODA, KIJTIM, Drita, BESHIR, KLEZAI, VASHJE, BESHIR, DOMI, LAVOJE, BESHIR, NDOJA, ISAK, SULLEMAN, DODA, ZAHIDE, ISAK, KASTRATI, MUSTAFA, ISAK, DODA, MUHAMMARE, ISAK, DODA, LAZAM, ISAK, DODA, FITE, ISAK, KOLDASHI, BUKAJURE, ISAK, FERDOSH, XHEVHARRE, ISAK, KOLEKT, JAVNI, ISAK, DODA, SKENDER, ISAK, DODA.

DOSJE E PËRSHMË: ARIF & TRASHËGIMTARË HANE (MOTRA) ME ZEVENDESIM (PËR VELLIN BESHIR) NJUTM (DITA)VASHJE, LAVOJE, ME ZEVENDESIM (PËR VELLIN ISAK) ZAHIDE, MUSTAFA, MUHAMMARE, LAZAM, FITE, BUKAJURE, ISAK, FERDOSH, XHEVHARRE, ISAK, KOLEKT, JAVNI, ISAK, DODA. KYZEM KA AUTORIZUAR DRYTEN E CILA NUK ESHTË TRASHËGIMTARË PËR TERHQËN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR.

Shënimi: Kur dokumentacioni është i rreptshëm shënohet me X, kur kanë autorizuar me produkt shënohet me P, ndryshe i dokumentat.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 19424, RROK, NICA, ZEF, GJYSTE, RROK, RITAINICAJ, Drita, HYSAJ.

DOSJE E PËRSHMË: RROK & TRASHËGIMTARË HANE (MOTRA) ME ZEVENDESIM (PËR VELLIN RROK) NJUTM (DITA)VASHJE, LAVOJE, ME ZEVENDESIM (PËR VELLIN ISAK) ZAHIDE, MUSTAFA, MUHAMMARE, LAZAM, FITE, BUKAJURE, ISAK, FERDOSH, XHEVHARRE, ISAK, KOLEKT, JAVNI, ISAK, DODA. KYZEM KA AUTORIZUAR DRYTEN E CILA NUK ESHTË TRASHËGIMTARË PËR TERHQËN E DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR.

Shënimi: Kur dokumentacioni është i rreptshëm shënohet me X, kur kanë autorizuar me produkt shënohet me P, ndryshe i dokumentat.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 8616, ZENEL, MUHADRI, Feride, ZENEL, MUHADRI, DAVA, DOD, GIETA, ZEF, DOD, KUCAJ, LLESH, DOD, KUCAJ, MIRE, DOD, MARKU, PRENDA, DOD, NIKOLLA, DRANE, DOD, DODA, MARKU, DOD, KUCAJ.

MUNGON: DESHMI TRASHËGIMTARË LLOGARË PËR DËM SHPËRBLIMIN FINANCIAR. DOKUMENTI E POSACME NUK ESHTË E VLESHME PASI ESHTË E VITIT 1995 DHE KA TË BËJE ME TERHQËN E LETRAVE ME VLERË DOKUMENTI TË PERPULOJNE NË PROKURE TË RE OSE TË SJELLIN VERTETIMIN NË LLOGARË LESHMIRE, PRENDA, DRANE.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 8616, ZENEL, MUHADRI, Feride, ZENEL, MUHADRI, DAVA, DOD, GIETA, ZEF, DOD, KUCAJ, LLESH, DOD, KUCAJ, MIRE, DOD, MARKU, PRENDA, DOD, NIKOLLA, DRANE, DOD, DODA, MARKU, DOD, KUCAJ.

Dosje e plotë për kësht të Parë shqyrtuar në datën 01.06.2017. Dosje e trashëgimtarëve.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 15153, Esat, Shqeca, 500, Muharrrem, Esat, Shqeca, Faris, Drita, Demir, Faris, Djalila, Demir, Faris, Denada, Demir, Faris, Kulla, Varvara, Avni, Tekno, Luçman, Avni, Malesi, Ismet, Avni, Malesi, Mirgjeta, Avni, Malesi, Didane, Esat, Dushko, Zamir, Esat, Shqeca.

Dosje e PËRSHMË për kësht të parë, shqyrtuar në datën 14.08.2014. Esat e trashëgimtarëve Esat, Drita, Dushko, Didane dhe Zamir.

Diana e trashëgimtarëve Drita, Dushko, Daniel dhe Denada. Drita, Dushko, Daniel dhe Denada i kanë dhënë prokurë Manir, Luçman e trashëgimtarëve Varvara, Luçman, Ismet dhe Mirgjeta. Varvara, Luçman, Ismet dhe Mirgjeta, nuk do arrijnë dot sa të sjellin certifikatë e vdekjes sa Luçman dhe certifikatë personale. Për më gjerë mundon vetëm certifikatë personale.

Didane dhe Zamir i kanë dhënë prokurë Manir.

Për pagesë për kështin e parë janë Manir, Drita, Dushko, Daniel, Denada, Didane dhe Zamir.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 19424, Shaban, Shahini, 99, Riza, Shaban, Shahini, Vero, Riza, Tufa (Shahini), Fatmir, Riza, Shahini, Bedri, Shahini, Lumturije, Riza, Duka (Shahini), Mimoza, Riza, Shehi (Shahini), Xhevdet, Ahmet, Shahini, Behare, Ahmet, Sabi (Shahini), Futura, Ahmet, Isak (Shahini), Gazmend, Ahmet, Shahini, Shpetim, Fadri, Shahini, Adnan, Shaban, Shahini, Xhevit, Shaban, Shahini, Arta, Xhevit, Vriani (Shahini), Erjeta, Xhevit, Hala (Shahini), Kujtime, Xhevit, Gijrmi (Shahini), Ibir, Xhevit, Shahini, Ikbate, Shaban, Vriani, Fiqrete, Shaban, Shahini, Ardjan, Naim, Shahini, Myrtrije, Shaban, Dizdari (Shahini).

Dosje e pËRSHMË për kësht të parë e rishqyrtuar në datën 14.08.2017. Në bazë të dok të reja të ardhura, dosja njëqiset e plotësohet.

Shaban e trashëgimtarëve Riza, Ahmet, Fadri, Adnan, Xhevit, Ikbate, Fiqrete dhe Myrtrije. Riza e trashëgimtarëve Vera, Fatmir, Bedri, Lumturije, dhe Mimoza. Xhevit, Futura dhe Gazmend. Xhevit, Futura dhe Gazmend. Xhevit, Futura dhe Gazmend. Agon nuk paguhet për mungesë dok ligjor. Kujtime dhe Ibir i mungojnë certifikatë personale dhe vërtetimet e në të llogaritë bankare.

Për pagesë janë Vera, Fatmir, Bedri, Lumturije, Mimoza, Behare, Shpetim, Aslan, Arta, Erjeta, Ikbate, Ardjan dhe Myrtrije.

Table with 18 columns: NR DOKUMENTI, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESIA, MBIEMER, DATELIN DIA. Row 1: 20984, Arlin, Basha, 509, Perparim, Gërqe, Ndrek, Basha, Roland, Perparim, Basha.

Dosje e plotë për kësht të parë shqyrtuar në datën 31.05.2017. Arlin e trashëgimtarëve prindit Perparim dhe Gërqe. Perparim e trashëgimtarëve Gërqe dhe Roland. Gërqe marrë pjesën e sajë dhe ka prokurë për Roland.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E NIVELIT TE PARE, TRASHEGIMTARET E NIVELIT TE DYTE, DOKUMENTAT, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE E PLOTE
IBRAHIM E TRASHEGIMTARET HAYSEN,NURIE,BUAR
HAYSEN E TRASHEGIMTARET FAMILIAR,ANEZA
Buar e trashegime femije edua, Alodan

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e plete per keshtu te pare rishqyrtuar ne daten 05.08.2017.

Mytzeza e trashegime Muhamem dhe Mereme (motra dhe vellja)
Muhamem e trashegime Pajazit,Qamili,Sejfulla,Gani dhe Nurije
Pjesa e Pajazit,Qamili, Gani dhe Nurije qe kane vdekur e merr Sejfulla.
Mereme e trashegime Ali,Hysen,Shyqiri,Divlver, Lumturie dhe Lirije. Ali, Hysen, Shyqiri dhe Lumturie kane vdekur dhe pjesa e tyre i ndahet proporcionalisht midis Divlver dhe Lirije

Per pagese per keshtu e pare jane Sejfulla Divlver dhe Lirije.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e pjeseshme per keshtu te pare rishqyrtuar ne daten 27.07.2017

Xhemal e trashegime Dile (bashkeshorja) dhe femijet Sherif, Rasim, Sabedin, Barije, Xhelal, Haki dhe Bukurije.
Arben i Xhelal i Haki qe nuk eshte ne aktin e trashegime si prokure per Xhelal.
Dile e trashegime vetem femije e saj qe jane Xhelal, Haki dhe Bukurije
Rasime trashegime motrat dhe vellezert Sherif, Sabedin, Barije, Xhelal, Haki dhe Bukurije
Sabedin e trashegime motrat dhe vellezert Sherif, Barije, Xhelal, Haki dhe Bukurije
Sherif dhe Haki nuk do paguhen deri sa te shpallen certifikatat personale dhe vertetimet e tyre te Ilgojane bankare.
Bukurije e trashegime Bashkim, Afrim Tomorr dhe Oltimi, Bashkim merr pjesen e tij dhe ka prokure per Afrim, Tomorr dhe Oltimi,

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e Kujes per keshtu te pare shqyrtuar ne daten 31.07.2017

Mihal e trashegime Evanthia,Vasilio,Eleni,Dhimitri,Jakaj,Sevasti,Oliga J,vieni dhe Athina.
Luanthia ka vdekur dhe pjesa e trashegime te kane shpallur e trashegime se Evanthie me femijet.
Vasilio e trashegime Anila, Theodorina, Kinto dhe Vasilj.
Trashegimtare e Vasilio nuk do paguhen deri sa te shpallen certifikatat personale dhe vertetimet e tyre te Ilgojane bankare

Eleni e trashegime Jorgo, Kosta, Afronit dhe Valerina.
Trashegimtare e Eleni nuk do paguhen deri sa te kene certifikatat e transportimit te denit sa te disponime certifikatat personale
Dhimitri e trashegime Evanthia, Margareta, Antoneta, Jorgji, Mihallaq dhe Luta.
Trashegimtare e Dhimitri nuk do paguhen deri sa te disponime certifikatat personale dhe vertetimet e tyre te Ilgojane bankare
Sevasti e trashegime Nesti dhe Petraq.
Trashegimtare e Sevasti nuk do paguhen deri sa te shpallen vertetimet e tyre te Ilgojane bankare dhe certifikatat personale.
Doja nuk kalon ne pagese. denit ne plotesimin e rrethe dokumentacionit ligjor te sipermenduar.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e plete per keshtu te pare, shqyrtuar ne daten 06.06.2017

Veli e trashegime Platon.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E NIVELIT TE PARE, TRASHEGIMTARET E NIVELIT TE DYTE, DOKUMENTAT, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE E KUJES
ISLAME TRASHEGIMTARET HANE(BASHKESHORTIA), REZAIMJE ZVENDESIM (PER ASLLAN) ZYLFI,ZAMRAXAJ,ME ZVENDESIM(PER SHEFI) ARJAN,FLORIDA
MUNGON DOK.LIGJOR PER HANE,CERTIFIKATE VDEKJE

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e pjeseshme per keshtu te pare, shqyrtuar ne daten 20.06.2017

Jusuf e trashegime Lazam,Selman,Bahrije,Nazife,Mide,Merjeme,Emrie,Muedin
Lazam e trashegime Dali dhe Avni

Dali ka prokure per Nazife

Selman Bahrije nuk paguhen deri sa te keni kopje te ID dhe te Ilga Bankare
Midgejuaqe e dyte e Jusuf, e trashegime femijet Merjeme, Emrie dhe Muedin. Muedin merr pjesen e vet dhe ka prokure per Merjeme dhe Emrie.

Per pagese per keshtu te pare jane Dali, Avni, Nazife, Merjeme, Emrie dhe Muedin.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e Plete per keshtu te pare, shqyrtuar ne daten 21.06.2017.

Mark e trashegime Maruke.

Maruke eshte per keshtu te pare.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e Plete per keshtu te pare,rishqyrtuar ne daten 04.07.2017.

Gjoni e trashegime Pjeter dhe Pjeter e trashegime Preza.

Preza (Prenda) Lulaj (vata) ka drekte prokure Val Vates qe nuk eshte ne aktin e trashegime.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e plete per keshtu te pare, shqyrtuar ne daten 07.07.2017.

Bajram e trashegime famijet Kasem, Skender, Zylfja dhe Bajram.

Pjesa e Bajram Bajram Votues, ndahet me me vellezert dhe motrat Kasem,Skender,Zylfja Pasi Bajram Bajram Vota ka vdekur 2 vjec.

Kasemin e trashegime Arben,Ismet,Gentiana,Avni,Bajram dhe Anila

Arben,Ismet,Gentiana,Avni,Bajram, Anila, Skender dhe Zylfja do paguhen per keshtu te pare.

Table with 14 columns: SHI I DENUARI POLITIK, TRASHEGIMTARET E PARE, TRASHEGIMTARET E DYTE, DOKUMENTACIONI, NR. DOSJES, EMER, MBIEMER, VKM NR., Emer, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, KOPIE TE LETER NJOFTIM, NUMER PERSONAL L LOGOARI BANCARE, CERTIFIKATE VDEKJE, CERTIFIKATE E TRUNGU T FAMILIAR, DESHMI FRASHGIMIE, PROKURE.

DOSE e pjeseshme per keshtu te pare rishqyrtuar ne daten 07.07.2017

Bajram e trashegime famijet Kasem, Skender, Zylfja dhe Bajram.

Kalosh e trashegime me zvendesim per Bashkallant e vdekur femijet e tyre qe jane Per Bilal paguhet Kurt,Nezir,Julf,Zenepe, per Adem paguhet Ahmet, dhe per Halit paguhet Bukurije dhe Dife.

Pjesen e Isuf dhe Zenepe qe kane vdekur e marrin vellezert Kurt dhe Nezir

Nezir nuk do paguhet deri sa te shpallen vertetimet e tyre te Ilgojane bankare.

Trashegimtare e Isuf nuk do te paguhet per mungese dok.ligjor (certifikatat personale dhe vertetimet e numrave te Ilgojane bankare)
Kurt ka prokure per Ahmet.

Per pagese per keshtu e pare jane vetem Kurt dhe Ahmet

Mercana Nezir, Bukurije dhe Dife qe jane po per keshtu te pare nuk do paguhen deri ne plotesimin e dokumentacionit ligjor te sipermenduar.

BOTIMI

Fatmira Nikollë

“VAJZA E LIRISË”

Provokimi i Namik Dokles, për ‘pushkatimet’ e moralin e partizaneve

Hasime thua këtë shokut komandant, do të hesht, do të mbys zërin tim në greminat e urretjes dhe të përbuzjes. Por jo, nuk është e mundur ta kesh dhënë ti këtë urdhër komandanti im. Po më prangosni për një puthje, do të më bëni gjyq për atë që Rakua ma quan puthje të fshehtë, prishje të moralit? Po jo, o komandanti im, unë nuk e kam fshehur e nuk do ta fshij kurrë dashurinë.

Më thonë që jam mbuluar me një kapotë me atë partizanin që është nga fshati yt...

“Më udhëhiq mjeshtër, në ferr a parajsë. Kë merr për mjeshtër ai. Dushkon?”

Romani i ri i shkrimtarit Namik Dokle, rrok dy kohë, duke prekur tragjeditë e tyre të mëdha: pushkatimet, vrasjet e spiunimit në luftë e në diktaturë - dhe prostitucionin, emigracionin, vetminë, braktisjen, gjakmarrjen, grabitjen e fëmijëve, armët, pasurimin e shpejtë dhe të padrejtë në demokraci, historia e Bleonës së grabitur, martesat e vajzave me zor, martesat me burra në moshë, shitja e vajzave për para, ç’nderimi në të dyja kohët! “Lulet e skajbotës” (Toena) përmbledh ngjarje e kohë, përmes disa personazheve të një fshati, Gorës, si për të dhënë një panoramë të errët të Shqipërisë, me luftëtarë e pafundme për mbi-jetesë.

PANORAMA E DY KOHËVE

Personazhet janë përfaqësues të dy kohëve, dhe mes tyre mund të gesh emra të njohur të historisë a të ditëve tona, nga të pashkollët që arrijnë të hyjnë në “elitën” e vendit e deri te njerëzit e zakonshëm, nga figurat e njohura të luftës, te figurat e njohura të regjimit. Histori të bujshme e prapë të pazbardhura, rimerren në shqyrtim mes pendimit, dhimbjes dhe kujtesës.

“Ai që kur mbylleshin kishat e xhamitë lexonte citate pas citatesh, ai që kur xhamia u bë magazinë patatesh shkroi me gërma të mëdha ‘Rroftë shoku Enver Hoxha’, kur filluan rropamat e ndërrimit të sistemit fshiu në mur emrin e diktatorit dhe prej asaj dite shkruhej ‘Rroftë Hoxha’ - është një prej fjalive që tregon jo pak për personazhet që brenda ditës u bënë demokratë, a antikomunistë. Njëherit, trajtohet edhe ana e errët e luftës çlirimtare, që shpesh ka njohur vëllavrasjen, kur Dokle shënon në roman se vrasjet që bënin partizanët, qofshin edhe kushërinjtë e vet, sepse ishin me bajraktarin e jo me partizanët.

“Paralliu i vdekjes” është personazhi tipik i sho-

qërisë sonë që përmes korrupsionit ka mundur të ngrejë biznese që kanë mbjellë vdekjen. E megjithëse në biznesin e tij vdiq një 22-vjeçar, ai nuk erdhi në varrim. Dërgoi një mesazh ngushëllimi nga ishujt Maldive, ku kishte shkuar me dy-tre deputetë - shënon Dokle, duke shtuar se në vend të tij erdhi një ortak i biznesit, një ish-kapter që në ‘90-ën bëri para duke shitur batanijet e këpucët e magazinave e pak vite më vonë edhe kallashnikovë e tritol. Ishte ai kapter që dikur i këndohej kënga: “O Kurtish, kapter i motrës, pse po shkon si urithi i tokës? Kjo partia, he lum dada edhe mutit i jep gradat!”.


PERSONAZHET E KOMUNIZMIT

Janë shumë. Gjenden mes rreshtash, të ripërtërirë në laboratorin krijues Zaho Koka, Nexhmije Hoxha, Dushan Mugosha, Ramize Gjebre, por edhe Enver Hoxha. Ata vijjnë në këtë roman nën emra të tjerë, por me histori si të tyre, diku të plotë e diku në linja të holla që u mvishen njerëzve që përbëjnë korpusin e personazheve të tij.

“Edhe ti nuk më beson Hasime? Edhe ti i beson brokullat e Rakos? Çfarë do të heq pantallonat para teje, si më kërkoi ai pushti në shtabin e batalionit? Të më shikonte nëse e kisha humbur virgjinë? E po ta dini të gjithë! Unë nuk kam frikë nga dashuria, e dua po aq sa dua lirinë. Por të vërtetën ama! Të vërtetën, vëlla, dhe jo atë të gunave e gëmushave, jo atë të Rakos e të Zakos, jo”.

Vajza e lirisë krijon së largu linjat e historisë së Ramize Gjebreas, por do të jetë autori që do ta thotë nëse vërtetë është frymëzuar nga

Romani “Lulet e skajbotës”, spiunët e komunizmit e prostitucioni në demokraci



Namik Dokle

historia e saj, nga jeta e vdekja e saj, nga lufta e pajfësia e saj, nga tradhtitë që iu bënë asaj, nga shoqja e të tjerët, sivëllezërit partizanë. Dokle e vë atë në sfond luftime, ku një ndër njerëzit që “i hedh një grusht dhe” duke çuar në pushkatim është vetë shoqja e saj, tani e shtrë në moshë, e çmendur, por me kujtesë të fortë. Autori vendos ta bëjë këtë grua që ka tradhtuar shoqen e saj të rinisë, të pendohet dhe të

vuajë. Halla Hasime e di, që nuk ka det ta lajë dhe pranon me ulërima: “Unë e kam vrarë”.

Tek sprova “Mosmar-rëveshja” e Ismail Kadaresë ka një ndalesë të gjatë mbi Zaho Koken, Nako Spirun dhe Ramize Gjebrean (e njohur si Ramona) - një partizane me një bukuri të rrallë, ardhur në mal nga qyteti.

Vrasja e saj, që tronditi në atë kohë gjithë Shqipërinë. Aty, Kadare thotë se “Qysh pas pushkatimit të Ramonës përpara brigadës partizane, pyetja e pashmangshme, se ç’është kjo që ka ndodhur: gjyq partizan apo shteriat arab? S’ka resh-tur asnjëherë”.

“Po ish-i fejuari ku do jetë? Kushedi a do ta gjejnë dot, se do të jetë varrosur e zhvarrosur disa herë. Kjo dashuri i çoi të dy në vdekje. Po mikësja, e deleguara qendrore? Ah, ajo do të jetojë gjatë, sepse kurrë nuk pendohet. Unë s’kam faj, koha ka faj! Unë s’desha, koha më detyroi. Ia kam parë në sy dritën jeshile të smirës, sa herë që flitej për Vajzën e Lirisë, ajo ia bënte me sy Dushkos. Denoncuesi i saj nuk do

të jetë në gjyqin e së vërtetës. Askush nuk e gjen dot. Është më i pështriti i dramës”.

Anrila Spahija shkruan se te ky roman lodrojnë bashkë, në një gjeografi sa reale aq edhe mistike, jeta dhe vdekja, dashuria dhe urretja, dhimbja dhe gëzimi, krenaria dhe përcimimi, e shkuara dhe e tashmja; qielli, toka dhe nëntoka. “Kjo botë që njohim, por edhe një botë tjetër atje, në skajin ku njerëzit përveç ajrit frymëmarrin ende mite dhe legjenda. Mes këtyre faqeve, që i përpjnjnë gjatë leximit, është jeta e një popullsie të tërë, e cila e meriton të njihet, e rrokur e gjitha me një dorë. Me dorën e djathtë të autorit që e ka shkruar, përmes një stili sa realist aq edhe magjik, përmes përshkrimesh sa të gjalla e të preshme, aq edhe poetike e onirike”, thotë Spahija.

Halla Hasime, personazhi i Dokles, thotë: “Ia morëm kapelën me yll. Pastaj i morëm armët, kapelën. Më pas xhakatën dhe rripin. Pastaj... protokollin vrasës! Çdo gjë e llogarit me intësi si dhe në minuta...”

Asaj i bënë gjyqin e tmerrshëm pse ndau gunën me shokun që t’i shpëtojë acarit. Lëreni Vajzën e Lirisë do t’u thotë. Kemi dalë për të vrarë armiqet dhe jo djemtë e vajzat tona...”

LAMTUMIRË XHEPETO!

SHUHET AKTORI MËRKUR BOZGO

Lamtumirë Xhepeto! - shkruante dje regjisorja Elma Doresi duke kujtuar një episod të kohëve më parë me Mërkur Bozgon.

“Mërkur pse u vonove? Ti je përherë i pari nga aktorët që bëhesh gati për shfaqje?” - Elma, po luante komëtarja. Ku i dihet kur luan përsëri e nëse do ta shoh. Doja të të merrja njëherë të të thosha nëse mundet të mos isha në hapje të shfaqjes që ta shikoja.

- Ashtu? Atëherë pse nuk more?

- Pse do ta bëje? Qesha... (Askush nuk e di se sa do të jetojmë mendova) Natyrisht Mërkur!

- Atëherë po iki zemër, - tha ai.

Atë natë shfaqja u hap pa Mërkurin. Telefoni im u mbush me mesazhe nga ato që kishin parë shfaqjen “Elma ka është Mërkuri”, “Elma ka ndodhur gjë me Mërkurin”. Unë qesha. Ishte një çmenduri si regjisorja e di, edhe? Ai donte shumë ta shikonte atë ndeshje dhe mosha e tij nuk premtonte shumë”. Mërkur të falënderoj! Lamtumirë Xhepeto jonë!”

Aktori i njohur Mërkur Bozgo është shuar në moshën 80-vjeçare. Ai ka dhënë kontributin e tij të vyer në skenën shqiptare, me dinjitetin e aktorit të mençur, elegant dhe shpirtdashur. Skena, kjo dashuri e madhe, edhe pse në kushte jo të mira shëndetësore, e bëri i falë Palin, rolin



e fundit te “Radio Iliria”, personazhi që u duartrokkit gjatë në Tiranë e Prishtinë. Me një karrierë të gjatë në teatër e kinematografi, Mërkur Bozgo do të kujtohet si aktori i karaktereve. Ai lindi më 24 mars të vitit 1937 në qytetin e Gjirokastrës. Në vitin 1961 përfundoi studimet e larta në Degën Gjuhë-Letërsi në Universitetin e Tiranës dhe prej

këtë vit fillon punën në Estradën e Tiranës deri në vitin 1968. Roli i fundit i aktorit Mërkur Bozgo do jetë ai i hoxhës në filmin “Gjoleka, djali i Abazit” në vitin 2005 përkrash Enxhi Agushit. Në kinematografi ai përfshihet herët që në vitin 1975 në filmin “Në fillim të verës” në rolin e punëtorit që shënon me shenjë arkën me barut. Në vitin 1979 ai është në rolin e drejtorit të muzeut në filmin “Emblema e dikurshme”. Më 1981, Bozgo interpreton rolin e z. Ali tek filmi “Agimet e stinës së madhe”. Më 1987 ai është Andoni tek “Tela për violinë”. Më 1988 ai interpreton drejtorin tek “Stola në park”, film me regji të Buajar Kapexhiut. Në vitin 1997, ai interpreton rolin e klientit të

Evelinës tek filmi “Bolero” nën regjimin e Besnik Bishës. Regjisori Dhimitër Anagnosti e rikthen në rolin e Hoxhës më vitin 2006 në filmin “Gjoleka, djali i Abazit”, një karakter ku Bozgo spikat në interpretim. Vitet e fundit, përveç teatrit ai u angazhua dhe në seriale televizive si tek “Komuna e Parisit” apo “Bela”. Bozgo do të kujtohet gjithnjë për karakteret që ia pas, por edhe pozitivitetin që përcollti tek të gjithë ata që e njohën. Ndërkaq, Mevlan Shanaj shkroi dje se ishte “njeri i shkëlqyer, aktor i karaktereve mbresëlënëse”. Ai kujtonte se me Bozgon është njohur mbi 50 vjet të shkuara dhe ruan kujtime të pashlyeshme, për të mirin të sjellshmin, mikun, që dje në orën 13:00 u përcoll nga banesa e tij në Rr. “Ali Demi”.

E DIEL
12 Nëntor
2017

MILOSA O



Drama e Finiqit, qendrës së Epirit nuk ka të sosur

NGA PROF. ASOC. PANAJOT BARKA

Qyteti antik i Finiqit mund të vuajë ende sot dramën e gra bitjes së thesareve të veta, mund të vuajë braktisjen, mund të vuajë ndërtime të tona shpërfillëse për lashtësinë dhe rëndësinë e vet, por drama e saj e vërtetë dhe e madhe lidhet me faktin se ne i fshehim dhe iu fshihemi të vërtetës së madhe mbi rëndësinë e tij në botën antike.

Finiqui, faqja tjetër e civilizimit Dodonas.

Zbulimi i Dodonës me 1875, vërtetoi se civilizimi i saj i dha identitetin kulturor Epirit dhe Greqisë; lidhjen e saj me gjeografinë themeluese të botës mitologjike greke; konkretizimin e perandorisë homerike dhe të marrëdhënieve të heronjve mitologjikë me Epirin. Vërtetoi se Dodona përbente gjenezën

e teogonisë së sistemit politeist grek dhe të kozmogonisë në tërësi. Vërtetuan se në vet Epirin, civ-

ilizimi "qytetës" (sipas modelit të poliseve të tjera helene,) i kishte paraprirë luftës së Trojës.

Pra, zbulim i Dodonës solli argumente pa fund që rrezonin në mënyrë të padiskutueshme iden-

tifikimin e termit "barbarë" me termin "jo grekë" për Epirin. Njohta me këto zbulime, sidomos me mbishkrimet e viteve 370-368 p. Kr, detyruan Hammondin t'i konsiderojë pretendimet e mësipërme "kashtra" pa vlerë.

Në civilizimin dodonas, qyteti antik i Finiqit (si edhe Butrinti dhe qytetet e tjera të hapësirës midis Paksous, Korfuzit dhe Ilion-it të zhdukur) vërtetonte me mënyrën e vet rrënjët e lashta të civilizimit qytetës në Epir dhe relatat e tij të drejtpërdrejta me mitologjinë dhe kulturën e lashtë helene. Vërtetonte në këtë prizëm se ky civilizim qytetës, veçanërisht i Finiqit, nuk përbën një ndikim të vonshëm të kulturës së poliseve të tjera greke. Por, një rikthim në to, në formë të zhvilluar, të elementeve të veta kulturore, të cilat kishin udhëtuar prej kohësh nga Epiri drejt qyteteve të tjera helene. Kjo do të thotë se nuk qëndron teza e njohur se Epiri i lashtë i përfshi në botën e zhvilluar helene me mbretin Tharipat të Mollosëve, i cili me 423 p. Kr, i ndikuar thellësisht nga kultura Atikase, themeloi shtetin e tij në Epir, në bazë të sistemit politik të shtetit të Athinës.

→ Vijnë në faqen 14

Tragjedia e studentëve të Liceut Francez të Korçës

Nga auditorët europianë, në humnerën e diktaturës

NGA ERMIRA XHOMAQI

100 vjetori i Liceut Francez të Korçës, përbën një ngjarje të

shënuar në historinë e shkollës shqipe, sepse që në vitet e para pas Pavarësisë, ky lice luajti një rol sa të veçantë aq edhe të rëndësishëm në formimin e elitës shqiptare të

kohës dhe përhapi në Shqipëri kulturën franceze dhe vlerat e saj.

→

në faqen 16

A

ARGUMENT

Qyteti antik i Finiqit mund të vuajë ende sot dramën e grabitjes së thesareve të veta, mund të vuajë braktisjen, mund të vuajë ndërtimet tona shpërfillëse për lashtësinë dhe rëndësinë e vet, por drama e saj e vërtetë dhe e madhe lidhet me faktin se ne i fshelim dhe i fshihemi të vërtetës së madhe mbi rëndësinë e tij në botën antike.

Finiqui dhe drama e fshehjes të së vërtetës që qyteti antik mbart

NGA PROF. ASOC. PANAJOT BARKA

Vijon nga faqja 13

Në këtë drejtim qyteti antik i Finiqit, kryeqyteti i Kolonit (Unionit) Epirotas (232-168 p. Kr) përbën një rast të padiskutueshëm dhe të panegociueshëm. Nuk dihen themeluesit e tij, por nuk janë Helenët e ekspansionit kulturor të pas Luftës së Trojës si në rastin e Apolonisë, apo të Epidharnos. Dallon edhe nga Butrinti që mitologjia lidh themelimin e tij (në fakt ringritjen e tij) nga heronjtë trojan të mbijetuar pas rënies së Trojës) Formën që njohim sot nga rrënojat e tij Finiqui i mori diku rreth shek V p. Kr. Përbënte kryeqendrën politike, ekonomike, tregtare, kulturore dhe shoqërore të Epirit. Dallohej për teatrin e madhe antik, thembullin e perëndeshës Athina, akropolin, pallatet dinjitoze, agoranë, gjimnazin, nekropolin me sarkofage etj. Magjithatë njihje dhe respektonte vartësinë shpirtërore nga Dodona.

U shkatërrua, me 230 nga mbretëresha ilire Teuta dhe siç na njohon Polibi, ajo u verbua prej sasisë dhe cilësisë së plaçkës nga qyteti i rrënuar me popullsi të panumërt dhe nivel të lartë kulturor. Ndërkohë, kujtesa popullore konsideron edhe sot shkatërrimin e Finiqit si më të madhin e njohur ndonjëherë.

FINIQU DHE ROLI I TIJ NË ÇESHTJEN E ALFABETIT GREK

Finiqui në hartën e qyteteve thesprotë dhe kaonase të Epirit, përbën, paralelisht me komunikimin me Dodonën, një hallkë të pashkëputur marrëdhëniesh me pjesën tjetër të botës helene, me rol të shënjuar në gjeografinë e Kulturës së Egjeut. Pikërisht këtu duhet kërkuar dhe rrjeti i dendur të qyteteve me emrin e vet FINIQUI në këtë gjeografi.

Qytete me emrin FINIQU apo dhe tradita në lidhje me Finiqin, takojmë pothuaj në të gjithë Mesdheun, në Kretë, në Liban, në Italinë e Jugut, në Epir, në Korinth. Arsyet që çuan në krijimin e hartës me "Finikopolis", nuk janë njësoj të njohura si në rastin e Apolonive, apo më vonë të Aleksandri-ve. Sipas Herodotit pikënisja për qytetet "Finiqui" vjen nga Deti i Kuq. Rreth shek XX p. Kr, banorët e saj u vendosën në Finiqin e Libanit. Arritën kulmin e vet kulturor nga shek. XII deri në



shek.. IX p. Kr, si qytet jo helen dhe në të njëjtën periudhë u shtri në të gjithë Mesdheun, nga ku erdhi dhe alfabeti grek.

Një variant tjetër mitik përmend se fenikasit banonin në gjeografinë e Izraelit të sotëm, morën nga egjiptianët disa simbole grafike dhe me zhvillimin e tyre krijuan alfabetin e parë (i njohur edhe si alfabet semit). Po sipas këtij varianti, grekët në fund të shekullit IX p. Kr, morën alfabetin e fenikasve, e pasuruan me zanore dhe ia përshtatën gjuhës greke.

Ky argument, se grekët nuk e njihnin shkrimin para shekullit VIII p. Kr. mbeti rezistent deri gati para një shekulli. Humbi çdo qasje shkencore kur A. Evans zbuloi në Kretën Minoase shkrimet lineare A dhe B, simbolet grafike të të cilave kishin ngjashmëri të plota me të paktën 17 nga të 24 shkronjat e alfabetit grek. Shkrime kre-tase vijnë të paktën para shek XV p. Kr. Të njëjta shkrime u zbuluan edhe në Pillo, Mikenë, Tebë dhe deri në vijën e Danubit. Fenikasit e Libanit dhe shkrimi i tyre shfaqen

në histori në shek XII deri në shek IX p. Kr. Krahasoni i thjeshtë çoi Evansin në përfundimin e shkruar në veprën e tij Scripta Minoa, se Fenikasit e Libanit morën shkrimin nga Kreta e cila i kolonizoi ata rreth shek XIII p. Kr.

Konstatimi i Artur Evans në lidhje me përparësinë helene në zbulimin e shkrimit u vërtetua edhe nga profesori i shquar i arkeologjisë prehistorike Paul Faure, kur botoi mbishkrimet të dekodifikuar të shkrimit linear grek të gjendura në murin ciklopi të Pilikatëve të Itakës. Sipas metodave moderne shkencore, ato i përkasin shek XXVII p. Kr. E përforcon këtë tezë mbishkrimi me shkronja të alfabetit grek në Juros të Alonisos, (Sporadhes veriore) i gjendur mbi faqet e një ene të viteve 5

000 - 4500 p. Kr; fakti shkrimor në gjuhën greke i Soumerias që daton në vitet 3 200 p.Kr etj. Të gjitha këto dhe fakte të tjera, nuk lenë hapësira dyshimi se gjuha helene i paraprind gjuhës semitase të paktën 4000 vjet.

Pra faktet vërtetojnë variantin e kundërt, që Fenikasit nga territori Helen, Kreta, kolonizuan brigjet e Mesdheut duke patur me vete alfabetin grek.

Rasti i Finiqit të Epirit dhe miti i Kadmos, përbën një argument të fortë në favor të variantit të dytë. Profesori dhe akademiku grek Mihail Saqellariu thotë se Finiqui i Epirit, nuk lindi në bregun e Libanit. Emri Finiqui iu dha qytetit të Libanit, pasi banorët e atjeshëm ishin të dhenë pas ngjyrosjes së pëlhurave me ngjyrën e

veçantë të kuqe që helenët i thoshin "finon". Fjalët finon-finofinix janë greke. Sipas Liddell & Skott, hartues të fjalorit të madh të gjuhës greke kjo fjalë interpretohet me të kuqen e purpurt. Sipas historianit St. Sotiriu fenikasit e kanë prejardhjen nga qytetet minoase Finix dhe Limin Finikuntos të Kretës, të ndërtuara përgjatë mijëvjeçarit të tretë p. Kr.

Në këtë logjikë, Finiqui i Epirit, shton rëndësinë e vet në çështjen e alfabetit grek edhe për shkak të marrëdhëniesh të tij me Kadmon. Miti i Kadmos, ashtu si e Irakliut, është i shpërndarë kudo në Mesdhe, duke vërtetuar në këtë menyre edhe shtrirjen gjeografike të qyteteve "Finiqu". Rëndësia e veçantë e marrëdhënies së tyre ka të bëjë me "lajmin" se Kadmos solli në Greqi alfabetin grek nga "Finiqui". M. Saqellariu këmbëngul se Finiqui i Kadmos nuk ishte vendi i Fenikasve semitë, por Finiqui i Epirit. Ai shton akoma se me të njëjtin emër, Finati, është i njohur në fis epirotas, pasardhës të fenikasve të Epirit, të cilët nën udhëheqjen e Kadmos pshuan Biotinë. Ekzistojnë gjithashtu miti se Kadmos së bashku me të shoqën Armonia, (në martesën e të cilëve morën pjesë gjithë perënditë e Olimpjit), në fund të jetës së tyre braktisën fronin mbretëror në Tebë dhe u vendosën në Finiqu dhe se këtu lindën një pasardhës, Ilirion, i cili konsiderohet si paraardhësi i parë i ilirëve, mit që vendos marrëdhënien gjaku midis ilirëve dhe heleneve. Duke u nisur nga fakti se zbulimi i Dodonës vërtetoi se në Epir flitej greqishtja para viteve 2100 p. Kr dhe fakti i zhvillimit të madh të Finiqit dhe pjesëmarrjes së këtij qyteti në të gjitha zhvillimet e mëdha të rajonit më të gjerë, si edhe marrëdhëniet e veçanta me Kretën (në kuadrin e marrëdhëniesh të shumfishta të Dodonës dhe Epirit me civilizimin Kretas), është e pranueshme logjika interpretuese e mitit të Kadmos në lidhje me alfabetin grek dhe rolin e Finiqit të Epirit.

MARRËDHËNIET E VEÇANTA TË FINIQUIT ME PERËNDESHËN ATHINA

Perëndesha Athina, përbën një ekskluzivitet i Epirit. Në raport me gjithë teogoninë e origjinë dodonase, Athinaja përbën një rast të rrallë të ruajtjes së marrëdhëniesh shpirtërore me Dodonën dhe Epirin. Dhe në këtë areal bën përjashtim marrëdhënien e perëndeshës Athina me Finiqin, adhurimi ndaj së cilës ruhet edhe në traditën e mëvonshëm të krahinës. Por kjo

Athinaja, Epiri, Finiqui, Troja

Para se të flasim për marrëdhënien e drejtpërdrejt të Athinas me Finiqin, mund të bëhet një parantezë për të parë marrëdhënien me të gjerë të saj me Epirin dhe Trojën. Tërheq vëmendjen fakti se të gjithë heronjtë që mbetën gjallë nga Troja e rrënuar u kthyen në Epir, për të themeluar qytete, si në rastin e Butrintit, apo për të lenë pasardhës shtetëformues si në rastin e Mollosëve. Po ashtu qyteti që mbante emrin e parë të Trojës, ILION, gjendet sipas toponimeve, vetëm në Epir. (!)



P

PERKUJTIM

NGA ERMIRA XHOMAQI

100 vjetori i Liceut Francez të Korçës, përbën një ngjarje të shënuar në historinë e shkollës shqipe, sepse që në vitet e para pas Pavarësisë, ky lice luajti një rol sa të veçantë aq edhe të rëndësishëm në formimin e elitës shqiptare të kohës dhe përhapi në Shqipëri kulturën franceze dhe vlerat e saj. Frekuentimi i këtij liceu për pjesën më të madhe të atyre të rinjve arsimdashës nuk ishte një rastësi, por konsideohej si një portë e hapur drejt Europës. Dhe prej këtu merr udhë një histori e gjatë e pambarimtë e intelektualizmit shqiptar, gjurmët e të cilit me gjithë dramën e pësuar nën diktaturë mbërritën të gjalla deri në ditët tona! A ishte vallë zgjedhja e këtij liceu, ajo që do të udhëhiqte e do të përcaktonte në vitet e mëpasme fatin e jetës së asaj rinie të pasionuar pas dijes e kulturës perëndimore?!

Duke reflektuar këtë pyetje ndoshta shumëkush prej nesh sjell ndërmend atë institucion arsimor të shquar i cili funksionoi gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, nga viti 1917 deri më 1942. Asokohe koloneli francez Descoins, me urdhër të gjeneralit Maurice Sarraïl, komandant i ushtrisë së Lindjes dhe i forcave të Antantës, nënshkruan protokollin që shpallte krijimin e Republikës Autonome të Korçës, me president Themistokli Gërmënjin, nën mbrojtjen ushtarake të ushtrisë franceze. Në të njëjtën kohë Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve i ripërcaktoi Shqipërisë kufijtë e vitit 1913 dhe më 25 tetor 1917, Franca, bëri të mundur hapjen në Korçë të një Liceu Francez. Menjëherë pas formimit ky lice, i cili më vonë do të quhej edhe Lice Kombëtar, do të bëhej një nga më të njohurit në Ballkan, për cilësinë e programeve mësimore dhe të mësimdhënies, ndërkohë që krijimi dhe funksionimi i tij u bë pjesë e një historie të lidhur pazgjidhshmërisht me peripecitë politike që kalonte Shqipëria dhe qyteti i Korçës në ato vite. Sipas Jacques Bourcart-it, një geolog i Armatës Franceze të Lindjes i cili ka jetuar ato vite në Korçë, Franca ishte lëkundur fillimisht për hapjen e Liceut, dhe kjo për të mos provokuar zemërimin e qeverisë greke e cila synonte kontrollin e plotë të kësaj zone të Shqipërisë. Megjithatë koloneli Descoins këmbënguli deri në instancat më të larta franceze dhe paraqiti projektin e krijimit të këtij liceu, programet shkollorë të të cilit ishin krejtësisht të njëjtë me ata francezë dhe për këtë arsye Ministri francez i Arsimit Edouard Herriot-i, vendosi që diplomat e maturranteve të Liceut Francez të Korçës të ishin të barasvlershme me diplomat e bakaloreatëve në Francë.

Pikërisht aty, në bankat e këtij

Prej Liceut Francez të Korçës nis udhën një histori e gjatë e pambarimtë e intelektualizmit shqiptar, gjurmët e të cilit me gjithë dramën e pësuar nën diktaturë mbërritën të gjalla deri në ditët tona! A ishte vallë zgjedhja e këtij liceu, ajo që do të udhëhiqte e do të përcaktonte në vitet e mëpasme fatin e jetës së asaj rinie të pasionuar pas dijes e kulturës perëndimore?!

Tragjedia e studentëve të Liceut Francez të Korçës

Nga auditorët europianë, në humnerën e diktaturës

liceu, qindra të rinj shqiptarë u mbrujtën me idetë e iluminizmit e të së drejtës, të barazisë, të pluralizmit e të demokracisë, nisën projektet e tyre të para plot shpresa e dëshira për të ardhmen, lexuan për herë të parë pamfletet e Hygoit, admiruan Volterin në vlerësimin e tij për Gjergj Kastriot Skënderbeun, si edhe mësuan për gjithë ata shkrimtarë francezë që kishin ngritur lart figurën e heroit tonë kombëtar. Një frymë e re u ndje në gjeneratën e tyre dhe në krejt shoqërinë shqiptare, një entuziazëm i ri i mbartur nga ata studentë të talentuar, të etur për dije e kulturë, të cilët studiuin më pas në mbarë qytetet europiane: në Romë, Paris, Montpellier, Toulouse, Grenoble, Lyon etj, duke krijuar kështu atë plejadë të çmuar të elitës shqiptare, ëndrra e së cilës për një Shqipëri të re, do të zhytej shpejt dhe dhimbshëm në terrin që i ofroi diktatura.

Pjesa më e madhe e studentëve shqiptarë të ardhur në Francë në vitet '20-'30, kishin mbaruar Liceun Francez të Korçës dhe kjo edhe për faktin se vetëm studentët e këtij liceu pranoheshin pa kryer studime plotësuese në universitetet franceze dhe integrimi i tyre në to ishte i menjëhershëm. E ndër- sa për disa prej këtyre liceistëve jeta pasuniversitare vazhdoi një rrjedhë relativisht të qetë e të patruar, për shumë të tjerë vorbullë e saj i përfshiu dhe i flaku ata në një tragjedi të paparë.

Sigurisht ky shkrim merr për sipër jo të relatojë kalvarin nëpër të cilin u rrokullis jeta e të rinjve ish-liceistë të Korçës, të cilët pa dyshim, nëse do të jetonin, do të kishin qenë shtylla të forta në fusha të ndryshme të mendimit ligjor dhe të drejtësisë shqiptare, të shkencave politike dhe filozofisë, të ekonomisë dhe letërsisë, të mjeksisë, inxhinjerisë dhe agronomisë, të cilët do të vendosnin e do të ndërtonin bazat e një shteti shqiptar europian e demokratik, por gjithsesi këto rreshta janë një për- pjekje për t'u bërë homazh këtyre personaliteteve, jeta e të cilëve mori rrapëllimën e mbrapshtë dhe humbi e u shkatërrua në vitet e regjimit totalitar. Ata u shuan mizorisht në kulmin e shkëlqimit të tyre dhe ende nuk kanë gjetur vendin që u takon në panteonin e

Historia tragjike e liceistëve

Historia e ish-liceistëve të Korçës dëshmon për energji të tëra njerëzore të pafajshme, mbytur me një lehtësi kriminale nga "fitimtarët", nën diktaturë, ndërkohë që kontributi i tyre intelektual do të kishte qenë aq i çmuar dhe i vyer për Shqipërinë e pasluftës.



Bashkë liceistë në Liceun Francez të Korçës. Mes tyre edhe A. Rami. Viti 1928



Bashkë liceistë në Liceun Francez të Korçës. Mes tyre edhe A. Rami. Viti 1930

mendimit intelektual shqiptar. Historia e ish-liceistëve të Korçës, dëshmon për energji të tëra njerëzore të pafajshme, mbytur me një lehtësi kriminale nga "fitimtarët", nën diktaturë, ndërkohë që kontributi i tyre intelektual do të kishte qenë aq i çmuar dhe i vyer për Shqipërinë e pasluftës.

I referohem këtu, pikërisht viteve kur menjëherë pas çlirimit të vendit, idetë perëndimore dhe republikane të një elite të përgatitur në nivelet më të larta të universiteteve europiane do të binin ndesh me konceptin absurd stalinian dhe ideologjinë bolshevike të Lindjes. Ideologji e cila u diktua Shqipërisë në atë periudhë nga Enver Hoxha, një ish-liceist i Liceut Francez të Korçës, i cili u kaloi tangjent studimeve të tij për

pas vendosjes të diktaturës në Shqipëri.

Dhe lista e tyre është e gjatë pa fund...

Midis tyre edhe Sabiha Kasimati (1912-1951), vajza e parë shqiptare e diplomuar në Liceun Francez të Korçës, e cila përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Biologjike në Universitetin e Torinos në Itali. Megjithëse nuk u angazhua në politikë, ajo mbajti një qëndrim protestues ndaj regjimit diktatorial. U arrestua në vitin 1951, pas incidentit të bombës në Ambasadën Sovjetike në Tiranë dhe u pushkatua pa gjyq më 26 shkurt 1951, së bashku me 21 intelektualë të tjerë. Në vitet e gjata të internimit, pas lirimit nga burgu, Abdulla Rami (1908-1973), bashkëliceist e në të njëjtën klasë me Kasimatën e Hoxhën në Liceun Francez të Korçës dhe i lauruar në jurisprudencë në Universitetin e Montpellier-së,

do t'i kushtonte homazhit të Kasimatit përkthimin e një prej poemave më të njohura të poetit francez André Chénier. Në dorëshkrimet e Ramit kam lexuar mes vargjeve edhe këto rreshta shqipëruar prej tij:

Ç'përbuzje fisnike shprehë në buzë' e tua
Kur hakmarrësi xhelat erdh e t'u afrua

Me kërcënim e vdekje që s'të tundin fije...

Vet xhelati u zbeh me gjyqtarët e zi

E senatori i pështrirë me ministtrat e tij

Kur ti e pambrojtur as që njohe frikë

Fjala jote e ëmbël, e thjeshtë me bujari

Ju mësoi që krimi sado llahtari At' që braktis jetën s'e trëmb asnjë çikë.

Menjëherë pas përfundimit të studimeve në Francë dhe kthimit në atdhe, ai shërbeu si jurist e gjyqtar në jugun e Shqipërisë dhe më pas në Kosovë. Aderoi në rradhët e nacionalistëve shqiptarë të Ballit Kombëtar, me ëndërrën për një Shqipëri të lirë dhe Etnike. Arrestohet në dhjetor të vitit 1944 dhe vuan 18 vjet burg në birrucat e Burrelit së bashku me vëllain e tij të ideleve Hasan Rami (1905-1988), kujdestar konvikti në vitet 1927-1928 në Liceun Francez, më pas drejtor shkollë në Krutë e në Vlorë dhe nacionalist në rradhët e Ballit Kombëtar. Ai u arrestua në vitin 1945 dhe vuajti 10 vjet burg.

Historia e liceistëve të Korçës vazhdon më tragjedinë e mjekut



P

PROZA



Shkrimtari dhe diplomati Visar Zhiti, megjithëse larg vendit në shërbimin e radhës diplomatik, mbetet shumë aktiv me botimet e tij. Së fundmi po i propozojmë lexuesit dy botime të tij, romanin e vogël në italisht "Funerali i pafundmë" dhe "Si na erdhi ai, i ndaluar", që përmban esse, përshkrime udhëtimi, poezi, dokumente, një lloj përzierje e tyre. Në librin e dytë, ashtu si parashihet nga kopertina, ku janë si personazhe Jevtushenko dhe i biri i shkrimtarit, Atjoni, në një takim të tyre në Lugano, shtjellohet një si dialog brezash, kohësh, shpjegim i vetes, shpjegon autori. Libri përmban edhe shumë foto, një lloj kurimi nostalgjie që Zhiti i bën të shkuarës së tij të afërt, që e ka bregosur pafund.



P

POEZIA

Poeti ka zgjedhur regjistrin e tij linear lirik për të shprehur ngacnimet e kohëve të fundit. Prehja mbas lirikës duket edhe si një grishje për t'iu larguar frymës së ashpër të kohës...

NGA DEMIR GJERGJI

Sa shpirta pa trupa mbi botë!
Sa trupa pa shpirtin nën tokë!
Gëzo, shpirti im, që ke një bujtinë,
Vallëzo, trupi im, dëshmo
Gjithësinë!

'17

UDHËTIME...

-Parabolë-
Toka lundron orbitës së vet,
Në Tokë, kontinenti, drejt qendrës
ngarend,
Përmes kontinentit treni po nget,
Vagonëve te trenit karroca rrëshqet,
Uloku mbi karrocë ik ëndrës -
kometë,
Ku do të ndalet Toka,
Ku do të ngecë Evropa,
Trenit ku do t'i mbyllet porta,
Ku do të mbërrijë karroca,
Ulokun ku do ta lërë forca,
Përmbysur mbi ëndrën e vet!?

PAMJE PËRTEJ SHIUT

Shihet shiu,
Lëkundet si dantellë e vjetër.
Bie gjithkund,-
Shigjetë që s'ra në shenjë kurrë.
Flaka e diellit
Dhe hijet, dhe etjet,
Tani, -
Më larg se ti,
Pamjet përtej,
Janë kurmi yt që vishet,
Me mall e vetmi,
Kurmi yt,
Gjah i shenjuar
Nga heshtat e syve të mi.

MBRETËRESHA
E MBRËMJES

-Përrallëz-
Lë fronin dhe mbretërinë e vet,
Me 700 mbretëri dhe po aq skllëvër,
Pamjet plaken papritur përreth,
Asaj i falen njomshittë e verës.
Pranon pa mëdyshje çdo nder e
dhuatë;
Stërkalat sythave, përshpirtjet e
borës,
Dhe del nga mbretëria e vet
kryelartë,
Me varg luleshqerrash në vend të
kurorës.
Mbi vyshtkjen gjirit, pak pudër-
polen,
Në hirin e shpirtit ca farëza mbijnë,
Mbretëresha e mbrëmjes pas erës
po rend,
Si lodër fëmije lë pas mbretërinë.

VJESHTË VJENEZE

-Vals-
Një vejuhë veje-e-vjen nëpër Vjenë,
Ca zonjushë e kujtojnë, disa zonjë.
Nëpër vjeshtë zonja shfaqet si
refren,
Teksa vajzë endet qiejve me
avionë.
Gjeth e gjurmë nëpër sheshe
ngashërejnë,
Udhë e Qumështit nëpër kozmos
sos në hon...
Një vejuhë vjen e vete nëpër
Vjenë.
Violina më kot harkun e kërkun...
Vjenë, vjeshtë 2014

HYJNESHA

Erosi erdhi, eremit më gjeti.
"Më dërgoi Venusi të të them,
Se puna e tij kaq ishte...
Përsosë më tej hyjneshën Venerë!"
Po ç'mund të bëja unë, eremit i
njerë,
Më shumë se Venusi bëri në qiell?!
Veçse te buza t'i mbillja një puthje,
Veçse te jeta t'i shtoja ca muzgje,
Veçse te ashti t'i ndizja një flakë,
Veçse te shpirti t'i hapja një plagë,
Veçse te syri t'i pikja një lot,
Veçse te fryma t'i zgjoja një oh,
Veçse së thëlli t'i hapja një brengë,
Ta gdhendja pastaj statujë në
mermer,
Ta bëja të rronte në shekuj të tjerë.

U BINDA...

U binda, se e kuqja është prush i
së kuqes,
Nga buzët e tua në kurthin e
puthjes.
U binda, se e kaltra është qiell i së
kaltrës,
Nga frymëmarrja jote në flatrat e
fjalës.
U binda, se e gjelbra është lojë e
së gjelbrës,
Nga prania jote në hon të
mungesës.
U binda, se e zeza është zi e së
zezës,
Nga braktisja e vetes në mes të
harrësës!

NATË SHTRATI

- "Moj Pashone, moj shigjetëll,
Ike natën, më le vetëm" -
(Këndonte im atë)
Shigjetilla zhvishet nëpër gurë,
Si vetëtima tej në re,
Vështrimin tim e vesh lëkurë,
Dhe fshihet bashkë me të në dhë.

ZERO

Në rrethin e mbyllur të zeros,
Si brenda lëvozhgës së vezës,



Trajta uji

Një epos flirton me një eros,
Për tjetër shpjegim të Gjenezës.

Në trupin e burrit prej bore!

SHKRUMB

SHTRAT I TRADHTUAR
Brenda mureve, perdeve, qelqeve
të blera prej Tij,
Futur lëvereve të lara prej teje,
Mbi shtratin e shtrenjtë, mbërthyer
nga Ai,
Qeshja me buzët e tua,
Qaje me lotët e mi,
Nën dritën e një abazhuri,
Dhe hijen e Atij burri.
Të zhvishja me ankth, të puthja me
frikë.

Hija nëpër ty e klithja:
Po sikur të vijë!?
Po sikur të vijë!?
Të nesërmen mbrëma, nën trupin
e rëndë të Tij,
Qaje me lotët e tu, kyçur syve të mi:
"Ah, të ishte Ai! Ah, të ishte Ai!"

JAM UJI

Jam uji dhe pres të më falesh!
Më pe, brymë lulëzova kristalesh,
Më le, shkëmb u trupëzova në
akull,
Më erdhe, reve u ngrita si avull,
Më fole, mbi ty u shkunda shi,
Më pive, lumë vërshova te ti;
Nëpër kurm, i ngrohtë, nëpër shpirt
si lot!
Jam uji, që mos qofsha!
Uji,

GUSHT I NGUSHTË

Vapë ishte, dielli përpiqej të digte
më kot.
Thatë ishte, pylli hijen e kishte
kullotë.
Pluhur ngruhej, syri i stinës
kthjellohej në lot.
Zhurmë bëhej, ariet e blerta
shtegtonin me zogjtë.
Dhembje kishe, e qeshura ime të
dilte për zot.

GËNJESHTËR

Kështu si rrëshqanan ditët e gjata:
Andej me ndajnata, këtej me
mandata,
Po vijnë të shihemi sërish si dikur,

Të bindur se nuk do të gjendemi
kurrë!
Kështu si shkëlqehen ditët e
vogla:
Andej gogla-gogla, këtej popla-
popla,
E kotë ta lemë takimin për mot,
Më mirë po puthemi e ndahemi që
sot!

KTHIMI I
KRYELUFTËTARIT

-Motivuar nga "Gjeorgjikat" e
Virgjilit-
Armët i dorëzova,
E zhvesha parzmoren,
Nuk më premtan koha,
Të festoj fitoren.
Gradat e karrierës,
Po i shqep nga supet.
Fushën e betejës,
Ta plugoj më duhet.
I zbraz prej urrejtjesh,
Me grurë i mbush grushtet.
Është kohë mbjelljesh,
Jo lakmish për bustet.

KOHA E KARENINËS

Një kohë dimërore të qepeje nga pas,
Të bëhej lëkurë, të vishje fustan.
Gjithkund të kanosej: "Do të të vras!"
Gjer erdhi t'iu bë qefin e temjan.
Ç'ishte ky hekur gulçues, i rëndë
Mbi mishin dhe eshtrat e tua fildish?!
Mbi fluturën e frymës ç'deshi kjo
gjëmë?!
Ti shkove te vdekja, pa ditur se ç'ish!
Të ishte kjo kohë digjitalë atëherë,
Mbase diçka do të mbetej prej teje!
Dhe vetë Tolstoj, me mjekrën në
erë,
S'do qante mbi penën që shkruante
pa leje!
Ose të ishte një Anë e sotme,
Për shembull, kjo që po shkon para
meje,
Një vjershë do ta nisja, që ty të të
mbronte,
Vetëvdekjes t'i ikje, kur kokën ta
ktheje.

MBYTJA E PYLLIT

-Kronikë në tri kohë-
I. Vjeshtë:
Pylli,
Me thundrën e ujit në fryt,
Dha frymë.
U mbyl!
II. Verë:
S'di ç'perëndi
E deshi ujanën për tjetër batërdi.
Pylli fatzi
Qan hijen e tij.
III. Erë tjetër:
Ky peshk,
Nga gropat e syve të ketrit skelet,
Thërret
Vdekjen e vet!

Opinion *i* Ditës

Prapë hapa, pastaj data!

Nga Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faja 1)

... Në përgjigje të kërkesës së përsëritur të kryeministrit Edi Rama mbi çeljen e negociatave të antarësimit në BE duke vlerësuar arritjet, Hahn kërkoi sërish hapa dhe dëshmi e prova të tjera për realizimin e pesë përparësive tashmë të njohura, me theks të veçantë në zbatimin e vetingut dhe luftën ndaj drogës. Ai e kompensoi mungesën e një date të shpejtë me rikompozimin e mbështetjes së BE-së për zgjerimin, duke përfshirë dhe organizimin e një samiti të posaçëm të Ballkanit Perëndimor në maj 2018.

Lidhur me çeljen e këtyre negociatave, ndonëse në pamje të parë nuk ka arsye për optimizim, qeveria dhe autoritetet tona përkatëse përballen me një afat që e shton trysninë mbi to; diku në qershor 2019, institucionet evropiane dhe të gjitha vendet antare do t'u nënshtrohen zgjedhjeve të reja për Parlamentin Evropian dhe rikompozimit të tyre deri nga fundi i atij viti; për rrjedhojë, ato do të spondojnë gjithë axhendën, përfshirë dhe zgjerimin e mëtejshëm. Ndaj, këto negociata për ne duhet të fillojnë jo më vonë se fundi i vitit të ardhshëm, ose nga e keqja dhe tremujori i parë 2019, ndryshe do të rrezikohet shtyrja e tyre për në vitin 2020, vit që mund të sjellë të panjohura të tjera si pasojë e zhvillimeve të brendshme në BE.

Ndaj, këmbëngulja e qeverisë dhe diplomacisë shqiptare në drejtim të caktimit të një date sa më të shpejtë, veçanërisht me certifikimin e zgjedhjeve parlamentare, dhënien e shenjave të para premtuese për zbatimin e reformave gjyqësore, fillimin e procesit të vetingut etj., është e kuptueshme.

Por kujdes! Të shpejtojmë, por jo të nxitjmë, sepse përvoja tregon se kur nxiton, vonon. Duke pasur parasysh objektivin e lartpërmendur kohor, papritur caktimin nga BE-ja të një date që tani për tani duket e vështirë për shkak të procedurave dhe problematikës së saj të njohur, ajo që ne kemi plotësisht në dorë është përcaktimi i një harte rrugore konkrete afatshkurtër, me afat deri në muajin qershor 2019. Kjo përkon edhe me periudhën kur Komisioni Evropian do të bëjë vlerësimin e progresit të secilit vend dhe me samitin e lartpërmendur. Në atë hartë rrugore do të përcaktohen masat dhe hapat konkrete, realizimi i të cilave do të çojë natyrshëm edhe në vendimin përkatës të BE-së për çeljen e këtyre negociatave, pse jo maksimumi brenda vitit 2018.

Për këtë, po jap disa sugjerime dashamirëse si diplomat i përfshirë direkt gjatë 20 viteve të fundit në këtë proces në Ministrinë e Jashtme, në Berlin dhe dy herë në ambasaden/Misionin tonë pranë BE-së në Bruksel deri muajt e fundit; në drejtoritë përkatëse në ministri ka ekspertë dhe drejtues të aftë, ish-ambasadore në Bruksel dhe në metropole të tjera të rëndë-



sive evropiane; së bashku me Misionin tonë pranë BE-së në Bruksel, i cili vitet e fundit është kompletuar me një staf 100 për qind profesionist nën drejtimin e një titullareje me përvojë e të përkushtuar, ata po bëjnë maksimumin në këtë drejtim.

Por si edhe më parë, aq më tepër tani, gjithçka varet nga politika, mazhoranca, por edhe opozita, sepse në BE nuk do të hyjë vetëm diplomacia apo qeveria, por e gjithë Shqipëria.

Së pari, është e nevojshme të shmanget raportit i zhdrejtë që ekziston ende ndërmjet shpesh-tësisë së "refrenit" tonë për caktimin e një date dhe ngadalësisë në zbatimin e premtimeve që kemi dhënë. Fatkeqësisht, gjatë 20

viteve të fundit, pas këmbënguljes sonë me argumente, BE na ka dhënë afate dhe data të kësaj natyre, por i kemi zhgënjyer me mungesën e seriozitetit politik, megjithë fjalët e bukura dhe stërbetimet. Ndaj, veç procedurave të brendshme, BE është "dëgjur" nga një praktikë e tillë, ndaj dhe kërkon prova dhe realizime të prekshme.

Pengesë tjetër për caktimin e kësaj date nga ana e BE-së është fakti se viti 2017 ka qenë periudhë zgjedhore në vendin tonë, për më tepër gjysma e këtij viti u karakterizua edhe nga konflikti i njohur disamujor me opozitën. Zgjedhje të përgjithshme ka pasur dhe në disa vende të BE-së, si Austri, Holandë, Francë, Gjermani dhe së

fundi në Çeki. Madje, kjo vështirësi do të jetë edhe për këta dy muajt të mbetur e pak më tej, sepse ende këto vende veç Francës janë në procesin e krijimit të qeverive të koalicionit.

Në këto kushte, strategjia e vetme efektive do të ishte që muajt e mbetur deri në majin e ardhshëm t'i shfrytëzojmë pa zhurmë e pa bujë për të zbatuar detyrimet tona të njohura në pesë fushat përparësore. Aq më tepër që gjatë këtyre muajve të fundit, dosjet në këto fusha janë "pasuruar" me elementë të rinj "djegës" dhe problematikë - çështja "Tahiri", zbatimin e shpejtë të vetingut, shmanjia e dyndjes së kërkesave për azil, reformimi i administratës publike, etj., të cilat janë në lupën vëzhguese të BE-së.

Blloku i dytë madhor për çeljen e negociatave sa më parë brenda vitit 2018 është rinovimi i konsensusit të plotë politik, sidomos me opozitën. Marrëveshja e 18 majit mbetet një bazë e mirë dhe opozita do të tregonte shenja të emancipimit të saj politik dhe vizion që ta rinovonte atë marrëveshje, duke e ndarë përfundimisht nga debatet dhe polemikat e tjera. Ka ardhur koha të hiqet dorë nga sakrificimi i integritetit evropian për hir të disa inateve apo interesave pjesore dhe të çastit, padyshim ndër shkaqet kryesore të vonësës historike të negociatave me BE-në gjatë 20 viteve të fundit. Natyrisht që shumica parlamentare dhe qeveria kanë përgjegjësinë e tyre në ndërtimin e një dialogu konstruktiv me opozitën, me median dhe të gjitha grupet e interesit.

Komponenti tjetër madhor me

ndikim të drejtpërdrejtë në çeljen e negociatave ka të bëjë me kujdesin në marrëdhëniet me BE-në në të gjithë spektrin dhe elementët, pa nënvleftësuar asnjë aktor dhe institucion. Këtu ka rëndësi të kuptohet drejt nga politika se BE përfshin jo vetëm Komisionin Evropian, shumë të rëndësishëm, i cili bën dhe propozimet përkatëse për datat dhe negociatat; as vetëm Parlamentin Evropian, që ka një delegacion për vendin tonë dhe një raportier të posaçëm pozitiv si gjermani Kurt Fleckenstein, por veç tyre ka edhe Këshillin, ky i fundit përfaqëson të 27 vendet antare të BE-së, të cilat kanë ardhur duke e rritur ndjeshëm rolin e tyre.

Kësisoj, vendimi për hapjen e negociatave do të jetë produkt i përbashkët i të gjitha këtyre instancave dhe vendeve, duke filluar nga Gjermania, Franca, Italia e deri te Luksemburgu i vogël, por me peshën e tij të posaçme. Kjo kërkon kujdes, madje edhe kur bëjmë publike mbështetjen e njërit apo të tjetrit, pasi ka sensibilitet të shumta, duke shmanjur keqkuptimet dhe pse jo "xhelozitë" e rastit. Aq më tepër tani që veç lodhjes nga zgjerimi, në BE kanë dalë në pah përparësi të reja krahas prirjeve për thellimin e proceseve rivonuese. As të mos na shkojë në mendje se duke "përplasur" institucionet apo vendet antare me njëra-tjetrën për hartrin tonë do të përshpejtojmë datat dhe etapat.

Në këtë vështrim, një sy i vëmendshëm nuk ka si të mos vlerësojë demarshet dhe përpjekjet tona diplomatike për zgjidhjen e problemeve me fqinjin tonë, Greqinë deri te takimi aq i nevojshëm dhe dobishëm që po zhvillojnë dy ministrat e Jashtëm në Kretë, por edhe përpjekjet e vazhdueshme për akomodimin e pozicioneve edhe të ndonjë vendi tjetër lidhur me problemet e azilit, pakicave, etj; kësisoj, shmanget edhe ndonjë hezitim/kundërshtim i mundshëm lidhur me datën në fjalë. Moderacioni dhe takti në këtë drejtim nuk kompromenton kursin e pozicionit dhe parimet tona, por ndërkohë ndihmon për sheshimin e problemeve jo të pakta. Kjo është sfida dhe avantazhi i diplomacisë zyrtare, sepse asaj i duhet të shohë dhe trajtojë në dinamikë një seri aspektesh dhe problemesh në mënyrë komplekse dy dhe shumëpalëshe dhe në një plan më afatgjatë se sa aktorë dhe faktorë të tjerë politikë, ekonomikë dhe sociale.

Së fundi, po aq e rëndësishme është kujdesi nga politika për të mos kompromentuar apo dhe zbehur hapat dhe arritjet e lartpërmendura me pohime dhe deklarime me nuanca të tilla, që mund të krijojnë te partnerët tanë evropianë dhe gjatë hamendësimeve apo dyshime të ndryshme.

Gjithashtu, është shenjë serioziteti dhe mençurie që vërejtjet apo rezervat që mund të kemi për BE-në, t'i shprehim në kanalet dhe forumet e shumta që kemi me BE-në dhe jo jashtë tyre.

Ndryshe, politika në vend të drejtojtave, do të lehtësojë çeljen e negociatave, do ta pengojë, vështirësojë dhe vonojë edhe më tej këtë proces historik.

Dje në "Deutsche Welle"

Ballafaqimi me të shkuarën, ende në nxehje

Nga Anila Shuka

(vijon nga faqja 1)

...për drejtoreshën e kërkimeve të projektit "Bunkart", që viziton Arkivin e Stasi-t në Berlin. Atë dhe disa përfaqësues institucionesh që merren me të shkuarën, i ka ftuar Fondacioni për Ballafaqimin me të Shkuarën e Diktaturës Komuniste për një udhëtim studimor në Gjermani.

Njëri nga stacionet: Arkivi i Stasi-t në Berlin: Mbi një tryezë të vogël buzë rafteve janë vendosur disa qese me rriska dhe copa letrash. Janë dokumente të grisura nga bashkëpunëtorët e Sigurimit në vitin 1989, kur populli ende që i dehur nga gëzimi i lirisë dhe bashkimit dhe nuk mendonte për dosje. Zhdukja e gjurmëve mori fund në janar 1990, kur ministria u okupua nga aktivistët e revolucionit paqësor: 15.500 thasë me dokumente të tilla gjenden në arkiv, për rindërtimin e tyre, shteti gjerman jep miliona euro.

Ish-Sigurimi shqiptar kishte shumë më tepër kohë për të fshehur gjurmët. "Në fillim të viteve '90 u zhdukën në masë të gjitha dosjet që kishin lidhje me personat që morën pushtetin atëherë dhe që sot e kanë ende në Shqipëri", thotë Admirina Peçi.

Se sa të vështirë e bën zhdukja e dosjeve kërkimin e fajtorëve dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë, kjo është dëshmuar edhe në Gjermani, ku për shembull, ish-ministri i Brendshëm i RDGJ-së, Erich Mielke, nuk u dënua dot për krimet e bëra në komunizëm, por për diçka tjetër. Por, denoncimi me emër i personave përgjegjës dhe prezantimi i tyre në publik është i rëndësishëm, edhe në se ata nuk dënohen. Për Roland Jahn-in, të ngarkuarin federal për dosjet e STASI-t, fokusi i ballafaqimit me të shkuarën komuniste, sot, 28 vjet pas rënies së murit, është zhvendosur: "Nga 'kush ka bërë e çfarë ka bërë?', në 'si është sjellë ai person deri tani?' A është penduar? A ka kërkuar falje?". Dhe ky lloj ballafaqimi edhe në Gjermani është ende në fillesa.

Një ngushëllim i vogël për vizitorët e ardhur nga Shqipëria, që edhe Gjermania ka ende punë për të bërë në ballafaqimin me të kaluarën. Sabine Kuber, nga Fondacioni për Ballafaqimin me të Kaluarën thotë se ky është një proces që kërkon shumë durim: "Është si një maratone, e ne ndodhemi ende në kilometrin e katërmëdhjetë".

"Ndërsa Shqipëria është ende në fazën e nxehjes", shton Jonila Godole. Për të hapja e dosjeve është një nga sfidat kryesore që duhet të kapërcejë Shqipëria, në procesin e përbaljes me të shkuarën: "Pas ligjit dhe ngritjes së autoritetit përkatës, tani duhen hapur dosjet, në mënyrë që njerëzit të besojnë se



vërtet do të ketë drejtësi", - kërkon drejtuesja e Institutit për Media, Demokraci dhe Kulturë.

Sabine Kuder, që e ndjek Shqipërinë tashmë prej 10 vitesh, është më e butë në gjykimin e saj. "Kur shkuam në vitin 2006 nuk kishte thuar se asgjë, as institute historike, as muze që merren me të kaluarën, apo ndërtesa përkujtimore, kishte vetëm shoqata të

përndjekurish. Dhjetë vjet më vonë, ne kemi Shtëpinë e Gjeteve, Muzeun e Shkodrës, institute që merren me të shkuarën, tema është e pranishme në media, prandaj ne shikojmë një zhvillim".

Këtë pozitivizëm nuk e ndjen tekta flet me pjesëtarët e delegacionit. Sepse moshapja e dosjeve mbetet për ta një pengesë e madhe në hulumtimin e së shkuarës:

"Nuk mund të kemi një shoqëri të hapur pa arkiva të hapura", - thotë Admirina Peçi duke pasur parasysh jo vetëm dosjet e Sigurimit, por edhe dokumente të ministrive dhe dikastereve të asaj kohe, që ende konsiderohen si "sekret". Sipas saj, për një gjë të tillë mungon vullneti politik.

Por, edhe angazhimi i përbashkët i institucioneve dhe OJQ-ve që merren me këtë temë: "Zbardhja e të kaluarës nuk shihet si mision, por si treg dhe aktivistët ngurojnë të bashkëpunojnë, sepse mendojnë se mos i hyjnë në pjesë njëri-tjetrit", ankohet një nga anëtarët e delegacionit. Duke dhënë si shembull edhe faktin që disa syresh nuk i njiheshin fare me njëri-tjetrin para se të vinin në Gjermani.

Pikërisht ky ishte edhe njëri nga qëllimet e këtij udhëtimi, thotë drejtori i zyrës së Fondacionit "Konrad Adenauer" në Tiranë, Walter Gloss, që së bashku me degën e OSBE-së në Tiranë kishte organizuar udhëtimin: krijimi i një platforme të përbashkët bashkëpunimi për këto institucione.

HOROSKOPI

DASHI

Nëse doni të bini në sy për talentin tuaj dhe të merrni vendin e punës që endëroni, falë pozicionimit të Venusit me Plutonin, ky është momenti i përshatshëm. Mundësia për të qenë të suksesshëm rritet, nëse në vend që të rini në shtëpi, dilni me shumë dhe qëndroni me shoqërinë.

DEMI

Nuk keni pse të shqetësoheni për asgjë. Me Diellin që ka hyrë për të ndriçuar shenjë tuaj, nuk do të vini re as pozicionimin e Hënës. Mos i merrni shumë seriozisht vlerësimet jo shumë pozitive të një të njohuri. Së shpejti do të hiqni çdo dyshim.

BINJAKET

Me pozicionimin e Venusit dhe Plutonit, mund të arrini suksesin e lakmuar pa u shqetësuar dhe me qetësi shpirtërore. Në shtëpi ka nevojë për të bërë një rinovim. Lëreni veten të udhëhiqeni nga ndjesitë e mira.

GAFORJA

Jeni pak i shkuajtur apo jeni duke menduar për gjëra të tjera dhe nuk i kushtoni rëndësi se çfarë jeni duke bërë. Përpunimi të jetoni në të tashmen. Çdo çast është i vyer dhe nuk duhet ta çoni dëm duke parë nga e kaluara.

LUANI

Një perspektivë udhëtimi duket në horizont? Kapeni menjëherë mundësinë pa menduar shumë, pozicioni Hënë-Neptun do të bëjë që të jeni të mbrojtur. Nëse ka ndonjë ndryshim që duhet të bëjë, lëreni instinktin dhe fantazinë që t'ju udhëheq, nuk do të dështoni.

VIRGJERESHA

Ndonjë hezitim në lidhje me të ardhurat tuaja? T'i hidhni një sy bilancit të muajit është e udhës, nëse nuk e keni bërë ende. Nëse më pas llogaritë nuk dalin, do të ishte gjëja e duhur që të bënit disa gjëra më pak për të kursyer për atë që ju nevojitet vërtet.

PESHORJA

Në këtë moment mund të keni më shumë pretendime ndaj kolegëve, por edhe nga vetja tuaj, nëse doni të arrini objektivat e vendosura. Përdorni të gjithë energjinë për të bërë përparrime, ia vlen me të vërtetë barra qiranë.

AKREPI

Nuk mund të prisni gjithmonë përsosmërinë në çdo gjë. Nëse gjërat nuk shkojnë si duhet, analizoni njëherë veten, përpara se të fajësoni personin e parë që ju del përpara.

SHIGJETARI

Me Hënë në pozicionuar në një shenjë të ujt, ndeshmëria tuaj do të rritet jashtë mase. Ndërkaq, bëni kujdes për të mos humbur arsyen theksit për një gjest. Përdorni "armët" tuaja me kujdes, në të kundërt do të keni probleme.

BRICJAPI

Në vend që të përdorni dredhi që mund të kalojnë në raporte force, thjesht qëndroni sa më të qetë që të jetë e mundur. Është e vërtetë, nuk keni një "plan B", por ndoshta në fund situata do të kthehet në avantazhin tuaj.


UJORI

Mënyra sesi është pozicionuar Hëna ju jep shumë paralajmërimë, po ju i shpërfilloni ose bëni sikur nuk shikoni. Megjithatë, duhet t'i hapni sytë. Jini të vëmendshëm dhe mos u gënjoni. Nuk do t'ju pelqejnë fare që dikush të tallej me ju.

PESHQIT

Koha e mbarimit të punës është një kënaqësi e vërtetë, nëse filloni të ndihen pak të lodhur dhe mezi prisni orën kur të mund të shijoni lirinë. Merrni në dorë kohën dhe hapësirën tuaj, pa e vrarë mendjen se këni në krah.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Emri i Monet.
- Një top në rrijetë.
- Carl Edward, që shkroi Contact.
- Qe bukurshë që u hidhte ferë perëndive.
- Qe era hyjnore e japonezeve.
- Një pjesë e lartësive.
- Lumë në Rusi.
- Eshhtë i lartë ai i kampionit.
- Kalifi që themeloi Kairon.
- Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
- Janë në gjuhë.
- Ilioni portier.
- Markë makine.
- Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
- Inicialet e Mann.
- Një parabolë e tenisit.
- Fillojne tatepjeten.
- Ente Autonome.

VERTIKAL

- Inicialet e Santana-s, kitarist.
- Nota e diapazonit.
- Eshhtë frika nga shehet e hapura.
- Diftong në duar.
- Duhen në ekstreme.
- Qe libri erotik i Mallanaga Yatsyavana-s.
- Lauda ish-pilot i Formula 1.
- Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
- Një poemë.
- Fund tuneli.
- Një eleganat si Aramis.
- Qe kryeqyteti i Asirisë.
- Qe toreador i famshëm.
- Urdhëroi sakrificimin e flijgenias.
- Eshhtë pushteti i... bashkisë.
- Qe lumi i Karontit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishte gjuha e Jezu Krishtit.
- U shndërrua në dre nga Afërdita.
- Rex i Nero Wolfe.
- Nino, kompozitor i njohur.
- Një... story e John Le Carré.
- Shkroi Tregime të jshhtëzakonshme.
- Kufizojnë një sektor.
- Inicialet e Einstein.
- Inicialet e Mathieu, këngëtare.
- Kufizojnë sportet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Lindi Isakun.
- Në krye të bashkisë.
- Në djep kur nuk... je.
- Nota e diapazonit.
- Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
- Mbyllin akte.
- Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
- Diku në qendër.
- Rralë është përgjysmë.
- Bëri edhe Madame Butterfly.
- Norman, psikopati te Psycho.
- Të parat në sjellje.
- Vret me një re.
- Gjarpri që u vra nga Apolloni.
- Lindi Perseun.
- Besniku mesfushor
- Ai i vajtimit është në Jerusalem.
- Carol, aktore.
- Në krye të subjekteve.
- Rrëmbu Helenën.

VERTIKAL


- Ishte sundimtari i provincave perseisha.
- Inicialet e Duvall
- Cyte i njembjeditrave.
- Ishte armiqëe babilonasve.
- Shkroi Jacuqes le fataliste
- Eshhtë edhe tendencë.
- Joan i interpretuar nga Celentano.
- Jetojnë në vetmi.
- U soll në Europë në Jean Nicot.
- Ai i Aida-s është Radames.
- Një ishte edhe Decebali.
- Inicialet e Rohmer regjisor.
- Titulli i Bruce Springsteen.
- Hidhet një me... kërcim.
- U shkrua nga Camus.
- Fillojnë takimin.
- Fillojnë natën.
- Pierce teniste.
- Grisur pa gur.
- Fillojnë panikun.
- Shijuar pa shuar.
- Fleming, që krijoi James Bond.
- Kështu merr ai që... mbaron.
- Mbajtësja e topit në golf.
- Ekstreme për gotik.
- Carson i furnetti-t.
- Një padë kur s'është ai.
- Bëhen arianë me një anë.
- Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
- Bëhet nuse me ne.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			3	7		1		
7					8		6	4
2	8	9				3		
		8	6	5		1	4	
	9		4		2		3	
	2	6		8	1	7		
		3				5	9	1
5	4		9					7
	1		8	6				

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar


2	6	7	5	4	9	8	1	3
8	3	1	7	2	6	5	9	4
9	5	4	8	3	1	7	2	6
3	7	6	2	5	8	1	4	9
4	1	8	9	6	7	3	5	2
5	9	2	3	1	4	6	7	8
1	4	9	6	8	5	2	3	7
7	8	3	1	9	2	4	6	5
6	2	5	4	7	3	9	8	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Në republikën e mediokritetit gjeniu është i rrezikshëm. (Robert Gingersoll)
- Publiku është jashhtëzakonisht tolerant. Ai fal çdo gjë, përveç gjenit. (Oskar Uajld)
- Gjeniu i vërtetë është një mendje me fuqi të përgjithshme të madhe, të orientuar rastësisht në një drejtim të caktuar. (Samuel Xhonson)

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Vështirësitë kultivojnë në njeriu aftësi të domosdoshme për kapërcimin e tyre. (Filips)
- Ka njerëz, të cilët nuk lajthisin kurrë sepse mendja e tyre nuk prodhon asnjëherë mendime të arsyeshme. (Gete)
- Fol vetëm atëherë, kur ajo çfarë ke për të thënë është më e bukur se heshtja...
- A s'e sheh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndalë por prapë është i përçmuar. Imam Shafiu

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

HORIZONTAL

1. MONET
2. TOP
3. EDWARD
4. HERKULES
5. UR
6. ALPES
7. RUSIA
8. KAMPIONI
9. KAIFU
10. PETER
11. GJYLLI
12. KALIFU
13. HEBREW
14. DRE
15. NERO
16. GJYLLI
17. NINO
18. JOHN LE CARRÉ
19. SHKRI
20. JESU
21. PETER
22. GJYLLI
23. NERO
24. GJYLLI
25. GJYLLI
26. GJYLLI
27. GJYLLI
28. GJYLLI
29. GJYLLI
30. GJYLLI
31. GJYLLI
32. GJYLLI

FJALËKRYQI (2)

HORIZONTAL

1. ISAK
2. BASHKISË
3. DJEP
4. DIAPAZONIT
5. ERASMIT
6. AKTE
7. GOMARIT
8. QENDËR
9. BUTTERFLY
10. PSYCHO
11. SJELLJE
12. RE
13. GJARPRI
14. PERSEUS
15. MESFUSHOR
16. JERUSALEM
17. CAROL
18. SUBJEKTEVE
19. HELENË

VERTIKAL

1. SUNDIMTARI
2. DUVALL
3. NJEMBJEDITRAVE
4. BABILONASVE
5. JACQUES
6. TENDENCË
7. CELANTANO
8. VETMI
9. NICOT
10. RADAMES
11. DECEBALI
12. ROHMER
13. SPRINGSTEEN
14. KËRCIM
15. CAMUS
16. TAKIMIN
17. NATËN
18. TENISTE
19. GUR
20. PANIKUN
21. SHIJUAR
22. JAMES BOND
23. MERR
24. GOLF
25. GOTIK
26. FURNETTI
27. PADË
28. ANË
29. HANNIBAL LECTER
30. NUSE

Thënie të mençura

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

